

1. PSIKOLOGJIA E KESHILLIMIT

Pyetja 1.

Cila nga alternativat më poshtë është e gabuar?

- A. Klienti mundet të përfitojë edhe nga një proces i pa pëlqyer këshillimi
- B. Me këshillim merren vetëm psikologët, psikiatrit dhe punonjësit socialë
- C. Një këshillim profesional mundet që edhe të mos ndihmojë çdo klient
- D. Për këshillimin profesional të individëve sot tregu është tepër i përzier

Pyetja 2.

Sot këshillimi është një punë e këndshme, sepse këshilluesi:

- A. U shërben interesave të veta
- B. U shërben interesave të klientit
- C. Vuan bashkë me klientin
- D. Zhvillon egon e tij personale

Pyetja 3.

Është mirë që këshillimi të ofrohet kur:

- A. Kërkohe nga vetë personi që ka problemin
- B. Kërkohe nga të afërm apo shokë të klientit
- C. Klienti nuk është maturuar për të marrë këshillim
- D. Klienti nuk ka probleme serioze për shëndetin

Pyetja 4.

Është detyrim profesional që këshilluesi të bëjë përgatitje serioze për çdo seancë. Ndër alternativat më poshtë, gjej formulimin e gabuar. Procesi i këshillimit:

- A. Është një proces racional
- B. Ka probleme të panjohura
- C. Nuk është proces racional
- D. Nuk është proces drejtvizor

Pyetja 5.

Ndër alternativat më poshtë, gjej atë që është e gabuar. Këshilluesi besojnë se “klient i mirë,, është ai që:

- A. Bashkëpunon në seancë
- B. Është tepër i pashëm
- C. Nuk ka tentativë vetvrasjeje

D. Vjen rregullisht në seancë

Pyetja 6.

Në rekrutimin e klientëve, këshilluesi nuk duhet të:

- A. Mbajë një distancë profesionale
- B. Organizojë një seancë dëgjimore
- C. Pranojë menjëherë rolin e këshilluesit
- D. Qëndrojë në pozita profesionale

Pyetja 7.

Ndër alternativat më poshtë, cila do të ishte përgjigja më e saktë dhe më e plotë? Dëgjimi i klientit nga këshilluesi është një dëgjim teknik, sepse:

- A. Këshilluesi kujdeset të mbajë nën kontroll qëndrimet e tij
- B. Këshilluesi duhet t'i bëjë të ditura klientit qëndrimet e tij
- C. Klienti nuk e ka të nevojshme të dijë qëndrimet e këshilluesit
- D. Këshilluesi duhet të dëgjojë edhe veten edhe klientin e tij

Pyetja 8.

Që empatia bazë dhe nxitja të japin rezultatet e pritshme, ka rëndësi që këto të përmbajnë tri dimensione. Cila nga alternativat më poshtë, nuk është pjesë e këtyre dimensioneve?

- A. Asertiviteti
- B. Avancimi
- C. Perceptiviteti
- D. Reagimi

Pyetja 9.

Në procesin e këshillimit, nuk është e vërtetë se shprehja e keqardhjes së këshilluesit për klientin:

- A. Afron këshilluesin me klientin
- B. Është diçka që lind natyrshëm
- C. Është tregues i sjelljes empatike
- D. Zëvendëson sjelljen empatike

Pyetja 10.

Nëse do t'i jepnim një këshilluesi disa këshilla profesionale, cila nga mënyrat për t'u komunikuar klientëve empatinë nuk është e saktë?

- A. Bëni më tepër reagime të shkurtëra

- B. Jepini vetes më shumë kohë të mendojë
- C. Reagoni empatikisht vetëm me fjalë
- D. Reagoni empatikisht jo vetëm me fjalë

Pyetja 11.

Përmbledhja e asaj që është diskutuar, si shkathtësi themelore për këshilluesin, ka si qëllim kryesor të:

- A. Aavancojë një çështje drejt përmbylljes
- B. Nxitë klientin të thellohet në disa çështje
- C. Sfidojë dhe të bllokojë klientin e tij
- D. Vihet gisht në një çështje themelore

Pyetja 12.

Shkathtësitë komunikative të prezencës, dëgjimit, kuptimit, empatisë, nxitjes dhe përmbledhjes integrohen kur:

- A. Aktivizohen në varësi të nevojës që ka vetë klienti
- B. Këshilluesi aktivizon atë shkathtësi që e zotëron
- C. Këshilluesi kryen ato sjellje që kërkojnë këto aftësi
- D. Përdoren në varg dhe kryesisht njera pas tjetrës

Pyetja 13.

E veçanta e këshillimit psikologjik është se ai është:

- A. Edhe vlerësim diagnostik
- B. Kryesisht një proces i hapur
- C. Me fillim e mbarim të shpejtë
- D. Vetëm vlerësim psikologjik

Pyetja 14.

Këshilluesit mund të komunikojnë edhe pa fjalë me klientët e tyre. Për këtë, është mëse e nevojshme që këshilluesit të:

- A. Dërgojnë sa më shumë mesazhe joverbale tek klientët
- B. Dërgojnë edhe mesazhe, të cilat klienti nuk i dëshiron
- C. Njohin reagimet trupore edhe të vetes edhe të klientit
- D. Përdorin vetëm mesazhe joverbale që klienti i pranon

Pyetja 15.

Një nga pengesat për dëgjimin empatik të klientit është edhe Dëgjimi me filtrim, i cili:

- A. Eshtë pothuaj i ngjashëm me dëgjimin e pamjaftueshëm
- B. Mban vetëm lëndën që i nevojitet realisht çdo këshilluesi
- C. Realizon vlerësim dhe seleksionim të lëndës së dëgjuar
- D. Veçon lëndën e dëgjuar të nevojshme dhe të panevojshme

Pyetja 16.

Kur një klient ka filluar ta tregojë historinë e tij, këshilluesi bën përpjekje që historia të marrë formë dialogu, sepse në këtë mënyrë:

- A. Eshtë më e madhe mundësia për të treguar empati
- B. Eshtë më e vogël mundësia për të treguar empati
- C. Ka më shumë mundësi për t'i bërë pyetje klientit
- D. Klienti mund t'u rikthehet disa çështjeve kryesore

Pyetja 17.

Gjatë seancave, është më mirë që historia e klientit të fillojë:

- A. E mbarojë me pyetje e përgjigje
- B. Monolog dhe vazhdojë dialog
- C. Në formën e një monologu
- D. Vetëm në formën e një dialogu

Pyetja 18.

Gjatë këshillimit, që çështjet kyçe të shihen qartë, është e nevojshme që këshilluesi:

- A. Të kuptojë motivet e vetëdijshme të klientit të tij
- B. Të kuptojë kufizimet e ndihmës që i jep klientit
- C. T'i kushtojë vëmendje asaj që thuhet në seancë
- D. T'i kushtojë vëmendje asaj që thotë klientët e tij

Pyetja 19.

Kur këshilluesi e vlerëson profesionalisht të mprehtë problemin e klientit dhe e sheh veten të pazotë për t'u marrë me të, në këtë rast ai:

- A. E ndërpret menjëherë seancën me klientin
- B. E referon klientin tek një koleg që e njeh
- C. E ndërpret punën për të marrë ndihmë
- D. Vazhdon punën edhe pse nuk mundet

Pyetja 20.

Këshilluesit mundet t'i ndihmojnë klientët që të merren me të shkuarën e tyre, kur:

- A. E kaluara nuk vihet në funksion të kuptimit të së tashmes
- B. Diskutimi i të shkuarës nuk ndikon klientin të çlirohet prej saj
- C. Klienti nuk ka krijuar besimin se mund të çlirohet nga e kaluara
- D. Këshilluesi nuk ka aftësinë ta çlirojë klientin nga e kaluara

Pyetja 21.

Një nga arsyet kryesore pse klientët nuk ia dalin mbanë në situata problematike është se:

- A. Arrijnë të veprojnë në mënyrë inteligjente në favor të vetes
- B. Është vendosur një ekuilibër midis të folurit dhe veprimit
- C. Klienti ndihmohet që të marrë kryesisht në dorë fatin e vet
- D. Procesi i këshillimit mbetet një proces thjesht “për muhabetë,,

Pyetja 22.

Kur këshilluesi merret posaçërisht me historinë e klientit, është shumë e rëndësishme që t’i kushtohet vëmendje faktit nëse:

- A. Këshilluesi e përcakton masën e ndryshimit tek klienti
- B. Klienti e tregon historinë në mënyrë tepër të sinqertë
- C. Klienti nuk shqetësohet se ç’mendon këshilluesi për të
- D. Klienti e tregon historinë e vet me vërtetësi të dukshme

Pyetja 23.

Për të reaguar si duhet ndaj hezitimit dhe rezistencës së klientëve gjatë seancave, këshilluesi i mirë duhet të respektojë disa parime të përgjithshme për t’i menaxhuar ato. Cili nga këto parime nuk duhet zbatuar?

- A. Ta shikojë si diçka normale pak hezitim dhe rezistencë
- B. Të pranojë dhe të punojë me hezitime dhe me rezistenca
- C. Të jetë realist dhe fleksibël gjatë hezitimit dhe rezistencës
- D. Të mos përdorë persona të tjerë gjatë hezitimit dhe rezistencës

Pyetja 24.

Këshilluesit duhet të bëjnë kujdes kur sfidojnë, për të mos i lënduar klientët e tyre. Për këtë, ka më shumë vlerë fakti nëse ata:

- A. E vlerësojnë sfidimin si shkathtësi themelore për arritjen e suksesit
- B. Kuptojnë se sfidimi prish homestazën e funksionimit të personit
- C. Vlerësojnë se sfidimin e bën vetëm këshilluesi dhe jo klienti i tij
- D. Vlerësojnë se sfidimin duhet ta bëjë vetë klienti dhe jo këshilluesi i tij

Pyetja 25.

Duke patur parasysh përpjekjet që bëhen sot nga këshilluesit për të zvendësuar këndvështrimet disfunktionale të klientit me këndvështrime të reja, cila nga alternativat më poshtë nuk është e saktë?

- A. Detyra e këshilluesit është të ndryshojë konstruktionet mendore të disfunktionit
- B. Këndvështrimet disfunktionale që klientët kanë janë realitete të ndërtuara prej tyre
- C. Këshilluesit mund t'i ndihmojnë klientët t'i rindërtojnë këndvështrimet mbi botën
- D. Këshilluesit nuk mundet t'i ndihmojnë klientët të rindërtojnë këndvështrimet e tyre

Pyetja 26.

Cili nga rekomandimet më poshtë, nuk ndihmon klientin të ndryshojë sjelljen e brendshme vetkufizuese? Klienti fillon të:

- A. Merret me ato aktivitete që janë tepër specifike për të
- B. Ndërpresë ato aktivitete që i shkaktojnë probleme plus
- C. Pakësojë aktivitetet që e ndihmojnë të përballet me probleme
- D. Veçojë ato aktivitete që atij i shkaktojnë probleme plus

Pyetja 27.

Këshilluesit profesionistë sugjerojnë se për të ndihmuar klientët, që të sfidojnë sjelljen e jashtme vetkufizuese, ata duhet të:

- A. Fillojnë gradualisht t'i shikojnë gjërat ndryshe nga më parë
- B. Kërkojnë prej klientëve të analizojnë pasojat e sjelljes së tyre
- C. Vënë re se klienti kupton dhe vlerëson vetëm të drejtën e tij
- D. Vënë re se klienti nuk pret radhë për të folur, nuk kërkon falje...

Pyetja 28.

Gjatë sencave të këshillimit, në zgjidhjen e problemit që ka klienti, është e rëndësishme që vetë klienti:

- A. Ka nevojë për zgjidhjen e problemeve të tij nga njerëz të tjerë
- B. Të kuptojë se në ç'masë është përgjegjës për problemin e lindur
- C. T'i paraqitë problemet e tij sikur të ishin të pazgjidhshme
- D. Të mos marrë asnjë përgjegjësi për zgjidhjen e problemit të tij

Pyetja 29.

Si veprojnë këshilluesit, në mënyrë që klientët të heqin dorë nga interpretimet e gabuara?

- A. E ftojnë klientin të ekspozojë më gjerë çështjen
- B. I tregojnë klientit se interpretimi është i pasaktë
- C. Klienti arrin të zbulojë vetë interpretimin e pasaktë
- D. Orienton klientin në ato aspekte që nuk i shfrytëzon

Pyetja 30.

Empatia e avancuar, shkëmbimi i informacionit, vetzbulimi i këshilluesit, njehershmeria, sugjerimet, rekomandimet janë:

- A. Aftësi profesionale të posaçme për të sfiduar klientin
- B. Kundërpërgjigje ndaj anëve të errëta të klientit gjatë seancës
- C. Mënyra për të dalluar mundësitë e pashfrytësuara të klientit
- D. Teknika për të mënjanuar vetmastrimet e klientit në seancë

Pyetja 31.

Klienti mund të përpiqet që të çlirohet nga disonanca e vet, duke:

- A. Bashkëpunuar brenda seancës
- B. Çvlerësuar problemin që ka
- C. Diskredituar këshilluesin e tij
- D. U kërkuar ndihmë të tjerëve

Pyetja 32.

Empatia e avancuar ka të bëjë me:

- A. Mundësitë e veta që klienti nuk i shrytëzon
- B. Problemet e pazgjidhura që ka çdo klient
- C. Pamundësinë e klientit për të realizuar diçka
- D. Problemet dhe mundësitë e pashfrytëzuara

Pyetja 33.

Këshilluesi mund të ndihmojë më mirë klientin e tij, kur problemin e pikasur e:

- A. Bazon problemin vetëm në historitë e klientit të tij
- B. Formulon me gjuhë dhe lëndë nga historia e klientit
- C. Riformulon kryesisht dhe vetëm me fjalët e veta
- D. Shpreh me terminologji teknike të profesionit të tij

Pyetja 34.

Ndër alternativat më poshtë, gjej formulimin e gabuar. Gjatë seancave, herë pas here, klienti ka nevojë për informacion. Në shkëmbimin e informacionit është e rëndësishme që:

- A. Klientit t'i tregohet vetëm një pjesë e informacionit nga këshilluesi
- B. Këshilluesi të sigurohet se informacioni është kuptuar ashtu si duhet
- C. Në dhënien e informacionit të parashikohet edhe reagimi i klientit
- D. Të mos ngatërrohet dhënia e informacionit me dhënien e këshillave

Pyetja 35.

Në procesin e këshillimit, këshilluesi mund të përdorë edhe tregimin e pjesëve të historisë së tij me qëllime profesionale. Në këto raste, është e rëndësishme të theksohet se vetzbulimi i këshilluesit është i përshtatshëm kur:

- A. E ngarkon disi klientin
- B. Është shumë i shpejtë
- C. Është pjesë e marrëveshjes
- D. Jep rezultat kontradiktor

Pyetja 36.

Sipas këshilluesve me eksperiencë, aftësia e menjëhershme nuk është e dobishme në rastet kur:

- A. Klienti ka nevojë për udhëheqje
- B. Mes palëve ka lindur mosbesim
- C. Midis palëve ka pëlqim reciprok
- D. Në marrëdhënie vihet re tension

Pyetja 37.

Klientët i pranojnë më shumë sugjerimet e këshilluesve të tyre kur:

- A. Këshilluesi nuk lidhet dukshëm me klientin e tij
- B. Këshilluesit sfidon pa njohur kapacitetin e klientit
- C. Klienti nuk e ndjen që këshilluesi e ka kuptuar atë
- D. Mes dy palëve ekziston marrëdhënie e fortë pune

Pyetja 38.

Në vetvete, sfidimi i klientit nga këshilluesi i tij është:

- A. Kërkesë dhe shtërngim
- B. Një urdhër ultimativ
- C. Përballje e qëndrimeve
- D. Teknikë për të ndihmuar

Pyetja 39.

Ndër alternativat më poshtë, cila prej tyre është e gabuar? Klienti mund të sfidohet më lehtë nga këshilluesi kur:

- A. Midis tyre është ndërtuar marrëdhënie pune
- B. Njihet mirë kapaciteti i klientit për të vepruar
- C. Synohet të sfidohen kryesisht pikat e forta të tij

D. Synohet të sfidohen kryesisht pikat e dobëta të tij

Pyetja 40.

Këshilluesi duhet të ndihmojë klientin në procesin e vendimmarrjes. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të kuptohet që vendimmarrja:

- A. Është proces i ngatërruar dhe i fshehur
- B. Ka në vetvete shumë aspekte irracionale
- C. Kryesisht është e vështirë për t'u spieguar
- D. Ndhmon klientin të merret me atë që duhet

Pyetja 41.

Meqë mbledhja e informacionit është fazë e rëndësishme për procesin e vendimmarrjes, këshilluesi nuk i ndihmon klientët, nëse u sugjeron të:

- A. Administrojnë dhe analizojnë informacionin si duhet
- B. Bazohen vetëm në informacion me bazë emocionale
- C. Mbledhin atë informacion që do të ishte ideal për ta
- D. Mbledhin informacion të përshtatshëm për vendimet

Pyetja 42.

Sipas rekomandimeve të sotme, këshilluesit duhet të merren vetëm me personat që:

- A. E duan këshillimin për t'u çliruar nga përgjegjësi penale
- B. Janë rezistentë, ngurues dhe që e refuzojnë trajtimin
- C. Nuk dinë të reagojnë aspak ndaj trajtimit të këshilluesit
- D. Nuk kanë aq shumë mundësi që të përmirësohen vetë

Pyetja 43.

Cila nga alternativat më poshtë është e gabuar? Qëllimet e klientit, që të jenë të realizueshme, duhet të plotësojnë disa karakteristika. Më konkretisht, ato duhet të jenë:

- A. Asnjëherë fleksible
- B. Kryesisht sfiduese
- C. Sa më specifike
- D. Tepër të matura

Pyetja 44.

Cila nga alternativat më poshtë është më e sakta? Për të ndihmuar klientët, që këta të përcaktojnë qëllime realiste, këshilluesit me eksperiencë sugjerojnë se qëllimet e klientëve duhet të:

- A. Jenë me efekte sa më afatgjata

- B. Kenë përmasa të nivelit jomesatar
- C. Mos të dëmtojnë njerëzit e tjerë
- D. Përputhen me vlerat e çdo klienti

Pyetja 45.

Këshilluesit mund t'i ndihmojnë klientët e tyre të hartojnë e zbatojnë plane, duke:

- A. Nxitur kryesisht veprimin e menjëhershëm të klientit
- B. Përcaktuar rrugët më të mira për realizimin e qëllimeve
- C. U mësuar më tepër klientëve disiplinën e planit të tyre
- D. U zbuluar e spieguar vetëm dobinë e planit të tyre

Pyetja 46.

Planet e klientit nxitin më mirë veprimin e tij, kur ato:

- A. Mundësojnë një ngarkesë të balancuar pune
- B. Nënvlftësojnë pengesat për arritjen e qëllimeve
- C. Nuk vlerësojnë sa realiste janë qëllimet e klientit
- D. Nuk sigurojnë besim për realizimin e strategjisë

Pyetja 47.

Klienti e zvarrit zbatimin e planit të veprimit, sepse:

- A. Beson se e meriton të vuajë dhe s'ka më energji
- B. Dëshiron të dështojë dhe nuk merr përgjegjësi
- C. Është shumë i motivuar për të ndryshuar sjelljen
- D. S'ka përgatitje paraprake që të përballojë pengesat

Pyetja 48.

Klienti shpërblehet për veprimet e kryera, kur:

- A. Kryen mirë planin e tij të veprimit
- B. Lodhet dhe dëshpërohet tej mase
- C. Nuk duken rezultatet e pritshme
- D. Nuk dëshiron ndihmën e këshilluesit

Pyetja 49.

Nevoja për këshillim mund të lindë edhe pasi procesi i këshillimit ka mbaruar. Në këtë rast, klienti:

- A. Duhet të punojë kryesisht vetë, pasi i është “mbyllur dera,”
- B. Cakton takime jo të planifikuara me ish-këshilluesin e tij

- C. Ka mundësi të këshillohet edhe pse procesi ka përfunduar
- D. Nuk e vazhdon më planin e veprimit të miratuar prej tij

Pyetja 50.

Këshilluesi e sfidon klientin e tij, kur ky i fundit shfaq shenja ngurrimi për të vepruar, duke e nxitur atë që të:

- A. Kuptojë pasojat e ndryshimit dhe mosndryshimit
- B. Marrë vendime të rëndësishme të brendshme
- C. Punojë edhe vetë edhe me ndihmën e të tjerëve
- D. Përpiqet t'i zgjidhë kryesisht vetë problemet e tij

2. PSIKOLOGJIA SOCIALE

Pyetja 1.

Rretho alternativën më të saktë dhe më të plotë lidhur me objektin e studimit të Psikologjisë sociale. Psikologjia sociale studion:

- A. Jo vetëm mënyrën e të menduarit, por dhe sjelljen e individit në shoqëri
- B. Mënyrën se si mendon, ndjen dhe vepron individi në situata sociale
- C. Mënyrat socialpsikologjike të njohjes dhe përshtatjes me realitetin social
- D. Marrëdhëniet ndërpersonale dhe qëndrimet e njerëzve ndaj njeri-tjetrit

Pyetja 2.

Aftësia për të nuhatur se ç'tipa janë njerëzit me të cilët kemi të bëjmë quhet:

- A. Diferencim semantik
- B. Efekt halo, ose i jehonës
- C. Formimi i përshtypjeve
- D. Përshtypje e parë

Pyetja 3.

Predispozicion pozitiviteti do të thotë të:

- A. Kërkosh që të tjerët të jenë pozitivë me ty
- B. Mendosh pozitivisht për njerëzit e tjerë
- C. Rritësh tej mase imazhin e vetes në shoqëri
- D. Sillesh pozitivisht ndaj vetes dhe me të tjerët

Pyetja 4.

Ne kemi prirjen që të vlerësojmë pozitivisht ata që:

- A. Janë më të pashëm nga ç'jemi ne
- B. Kanë karakter të ngjashëm me tonin
- C. Shfaqin një modesti tepër të shtirur
- D. Vishen më mirë se sa vishemi ne

Pyetja 5.

Ne jemi të prirur që, për të konkluduar me korrespondencë, të bazohemi më shumë në:

- A. Në një motiv të sjelljes së personit
- B. Në disa motive të sjelljes së personit
- C. Tiparet e papërsëritshme të personit
- D. Tiparet e përbashkëta me të tjerët

Pyetja 6.

Zgjidhni formulimin më të saktë lidhur me qëndrimet. Ato:

- A. Janë reagime emocionale, veprime konkrete dhe mendimet tona
- B. Janë më tepër veprime kritike për sjellje të caktuara të personit
- C. Kanë kryesisht përmbajtje konkrete pozitive ose dhe negative
- D. Nuk janë predispozicione të mësuara të sjelljeve tona specifike

Pyetja 7.

Qëndrimet që ne mbajmë ndikohen nga:

- A. Ndikimi i prindërit, i miqve dhe shokëve
- B. Opinione e njerëzve të tjerë për diçkë
- C. Përvojat e këndshme e të pakëndshme
- D. Rrethanat dhe ndjesitë tona të çastit

Pyetja 8.

Cila nga metodat e mëposhtme është rruga më e mirë për të marrë vesh qëndrimet e dikujt:

- A. Arsyetimi mbi bazën e sjelljeve të tij të shkuara
- B. Intervistimi e anketimi i drejtpërdrejtë i personit
- C. Nisemi thjesht nga gjykimi ynë i çastit
- D. Pyesim të tjerët ç'mendon personi në fjalë

Pyetja 9.

Ndër teknikat e mëposhtme, për matjen e qëndrimeve, më e sakta duket se është të:

- A. Pyesim vetë personin për qëndrimin ndaj diçkaje
- B. Pyesim në lagje se ç'qëndrim mban personi
- C. Përdorim teknika projektive dhe teste të njohura
- D. Përdorim shkallën Likert si më tradicionalja

Pyetja 10.

Për t'u ndryshuar njerëzve qëndrimet nevojitet një:

- A. Auditor serioz dhe prestigjioz
- B. Komunikues që di gjuhë të huaja
- C. Ton i shtruar i bashkëbisedimit
- D. Lektor i njohur dhe i besueshëm

Pyetja 11.

Fakti i njohur i shoqërimit të reklamave me njerëz të njohur nga skena e artit, sportit e të tjerë spiegon se njerëzit:

- A. E pashëm mund të na i ndryshojnë qëndrimet më kollaj
- B. E shquar mund të na i ndryshojnë qëndrimet më lehtë
- C. Me pushtet mund të na i ndryshojnë qëndrimet më lehtë
- D. Tërheqës mund të na i ndryshojnë qëndrimet më lehtë.

Pyetja 12.

Leon Festinger njihet si formulues i teorisë mbi:

- A. Perceptimin e vetvetes
- B. Mospërputhjen kognitive
- C. Stereotipet seksuale
- D. Konformizmin social

Pyetja 13.

Njohja sociale përfshin:

- A. Kryesisht, perceptimin e njerëzve për veten e tyre
- B. Perceptimin e njerëzve për veten dhe për të tjerët
- C. Vetëm mënyrën si mendojnë njerëzit për veten
- D. Mënyrën si mendojnë njerëzit për mendimet e tyre

Pyetja 14.

Gjatë njohjes, ndonjëherë, njerëzit përpiqen të vlerësojnë padrejtësisht informacion jodiagnostik individualizues. Kjo dukuri quhet:

- A. Dembelizëm konjitiv
- B. Dihitim i stereotipeve
- C. Ekonomi e njohjes
- D. Naivitet individual

Pyetja 15.

Në procesin e njohjes sociale, shkalla e tretë e njohjes është e lidhur me:

- A. Kategorizimin
- B. Nxjerrjen e përfundimeve
- C. Organizimin
- D. Perceptimin

Pyetja 16.

Shumë studime theksojnë se gjatë njohjes sociale janë dy burime të rëndësishme që ushqejnë nxjerrjen e përfundimeve. Këto janë:

- A. Qëndrimet dhe emocionet e individit
- B. Sjellja dhe cilësitë dispozitive të individit
- C. Sjelljet personale pozitive dhe ato negative
- D. Sjelljet personale pozitive dhe ato neutrale

Pyetja 17.

Njerëzit mund të mbajnë edhe qëndrime kontradiktore. Në këto raste, ata përjetojnë tension, të cilin nuk e pëlqejnë dhe përpiqen ta shmangin me rrugët e mëposhtme, përveç:

- A. Ndryshimit të njerit prej qëndrimeve
- B. Qortimit të menjëhershëm të vetvetes
- C. Shpërblimeve që janë të pamërituara
- D. Shpërblimeve që janë të merituar

Pyetja 18.

Ideja se ne i ndryshojmë qëndrimet jo për të shmangur mospërputhjen kognitive, por në varësi të perceptimeve që kemi për sjelljen tonë, është e:

- A. Bibb Latane
- B. Daryl Bem
- C. Leon Festinger
- D. Stanley Milgram

Pyetja 19.

Rruga më e mirë e zbuluar deri më sot për të pakësuar ose eliminuar ndikimin e paragjyqimeve është:

- A. Diskriminimi i tjetrit
- B. Heqja dorë nga paragjykimet
- C. Kontakti i vazhduar
- D. Toleranca ndaj të tjerëve

Pyetja 20.

Paragjykimi është një qëndrim:

- A. I ngurtë, i bazuar, negativ
- B. I pabazuar, elastik, negativ
- C. Negativ, i pabazuar, rezistent
- D. Pozitiv, i ngurtë, i pabazuar

Pyetja 21.

Burimet e paragjyqimeve janë të gjitha sa më poshtë, përveç:

- A. Diversitetit, i cili është mjaft e vështirë të tolerohet
- B. Dëshirës së personit për të negativizuar jashtëgrupin
- C. Imitimit direkt të sjelleve të njerëzve të tjerë prej personit
- D. Ndikimit të kulturave të grupit ku rritet e formohet njeriu

Pyetja 22.

Si kudo në botë edhe në Shqipëri, numuri i divorceve është rritur. Duke gjykuar për divorcin, cila është alternativa jo e saktë:

- A. Djemtë adoleshentë kalojnë probleme tepër serioze sociale dhe shkollore
- B. Meshkujt dhe femrat nuk vuajnë njëllëj emocionalisht divorcin e prindërve
- C. Pasojat ekonomike rëndojnë më shumë tek femrat se sa tek meshkujt
- D. Si vajzat edhe djemtë e vlerësojnë tepër negative ndarjen e prindërve

Pyetja 23.

Cili nga formulimet e mëposhtme është më pak i pranueshëm, kur është fjala përse njerëzit konformohen? Sepse:

- A. Kanë frikë nga moskonformimi dhe pasojat
- B. Konformimi i sjell vetëm shpërblim personit

- C. Mendimi i të tjerëve është më i mirë se i tyre
- D. Nuk u besojnë shqisave dhe perceptimit të tyre

Pyetja 24.

Që grupi të konformohet me një pakicë, sipas Moskovicit, pakica duhet të jetë:

- A. E qëndrueshme dhe instistuese
- B. E qëndrueshme, instistuese dhe kompakte
- C. Kompakte dhe e qëndrueshme
- D. Kompakte dhe tepër dinake

Pyetja 25.

Ekspërimenti i Solomon Asch vërtetoi se njerëzit u konformuan nga që ata:

- A. Besonin me të vërtetë se përshtypja e tyre e parë nuk ishte e saktë
- B. Besonin vërtet se përshtypja e tyre e parë ishte tepër e saktë
- C. Nuk dëshironin të shkonin me grupin dhe të mos devijonin
- D. Mendonin se konformizmi ishte një sjellje e rëndësishme sociale

Pyetja 26.

Në eksperimentin e Solomon Asch, krahasimi i vijave u përdor për të treguar:

- A. Ndikimin e grupit mbi perceptimin
- B. Perceptimin e ndryshuar të personit
- C. Perceptimin e kufizuar të personit
- D. Streotipizimin e sjelljes së personit

Pyetja 27.

Qëndrimet e tjerëve ne mund t'i ndryshojmë me rrugët e mëposhtme, përveç:

- A. Kritikës së ashpër për qëndrimet që mbajnë
- B. Përdorimit të teknikës së karremit
- C. Paraqitjes së kërkesave të shumëfishta
- D. Kërkesës së hapur për të ndryshuar qëndrim

Pyetja 28.

Në kushtet e mëposhtme, të gjitha kanë lidhje me konformizmin, përveç:

- A. Faktit se sa tërheqës është grupi
- B. Faktit se ç'pozitë ka individi në grup
- C. Madhësisë numerike të grupit

D. Paqartësisë së situatës konkrete

Pyetja 29.

Sipas rezultateve që arriti Milgram, cili prej faktorëve të mëposhtëm nuk ndikoi mbi obediencën:

- A. Ashpërsia e sjelljes që u kërkohej subjekteve
- B. Aftësia e padiskutuëshme e eksperimentuesit
- C. Aftësia e viktimës për të mos u nënshtuar
- D. Prezenca e të tjerëve që nuk nënshtroheshin

Pyetja 30.

Stanley Milgram vërtetoi se njerëzit nuk u nënshtrohen urdhërave, kur:

- A. Kuptojnë motivet e urdhërdhënësve autoritarë
- B. Nuk ndjejnë përgjegjësi për të vepruar
- C. Nuk kuptojnë motivet e urdhërdhënësve autoritarë
- D. Vuajtjet e viktimave nuk janë të menjëhershme

Pyetja 31.

Disa nxënës e bëjnë me fjalë të lenë një orë mësimi dhe dalin shëtitje. Një shok i tyre nuk e dëshiron një gjë të tillë. Ai e pëlqen lëndën, ka marrëdhënie të mira me mësuesin dhe, megjithatë, e lë mësimin bashkë me të tjerët. Sjellja e tij është:

- A. Kompiante dhe konformiste
- B. Konformiste dhe obediente
- C. Kompiante dhe obediente
- D. Kompiante, konformiste dhe obediente

Pyetja 32.

Drejtuesi i një grupi duhet të ketë:

- A. Aftësinë për t'ju shmangur kërkesave të grupit
- B. Aftësi për të reaguar ndaj një situatë që ndryshon
- C. Aftësi për të bërë më shumë kompromise me të tjerët
- D. Cilësi përkatëse të personalitetit për të drejtuar të tjerët

Pyetja 33.

Efekti i spektatorit ka të bëjë me:

- A. Efektet që bën mbi spektatorin një spektakël i caktuar
- B. Faktin se anëtarët e grupit janë të prirur të mos japin ndihmë

- C. Ndikimin e spektatorit në mobilizimin e trupës që të dalë më mirë
- D. Personi i vetëm është më i prirur se grupi për të dhënë ndihmë

Pyetja 34.

Koncepti i shpërndarjes së përgjegjësisë shërben për të:

- A. Çliruar veten nga përgjegjësitë që nuk na takojnë
- B. Spieguar pse dhe si lind efekti i spektatorit
- C. Spieguar mënyrën se si lind efekti i spektatorit
- D. Spieguar se edhe spektatorët kanë përgjegjësi

Pyetja 35.

Studiuesi më i njohur për problemin e ndihmës është:

- A. Bibb Latane
- B. Konrad Lorenz
- C. Robert Baron
- D. Sigmund Frojd

Pyetja 36.

Sipas studiuesve, lehtësimi social në grup:

- A. Çon në stimulim psikologjik dhe produktivitet
- B. Çon më tepër në reagime jozotëruese të personit
- C. Ndodh vetëm gjatë bashkëveprimit me të tjerët
- D. Ndodh edhe pa praninë konkrete të tjerëve

Pyetja 37.

Shpesh, duam të dimë shkaqet pse ne dhe të tjerët mendojmë, ndjejmë dhe veprojmë në një mënyrë të caktuar. Procesi i marrjes së këtij informacioni quhet:

- A. Atribuim shkakor mbi gjendjet shpirtërore
- B. Atribuim i natyrshëm i gjendjes shpirtërore
- C. Parim intuitiv i shkakësisë së ndjesive tona
- D. Thjesht, informacion mbi gjendjet shpirtërore

Pyetja 38.

Modeli tradicional i atribuimeve përfshin:

- A. Analizën naive të veprimit, dallueshmërinë dhe konsensusin
- B. Atribuimet e qëllimit, të dispozitave dhe konfigurimin

- C. Skemat shkakore, kovariacionin dhe konsistencën e vet personit
- D. Vendndodhjen e shkakësisë, stabilitetin dhe aftësitë kontrolluese

Pyetja 39.

Studiuesit përmes një sërë eksperimentesh kanë konfirmuar se njerëzit i keqperceptojnë me lehtësi ngjarjet rastësore si konfirmuese të besimeve të tyre. Kjo dukuri lidhet me:

- A. Intuitën e personit
- B. Korrelacionin iluziv
- C. Mendimin iluziv
- D. Të menduarit automatik

Pyetja 40.

Të kujtuarit e episodeve të rrezikut, përcakton gjykimet e rrezikut. Ky lloj arsytimi social i përket Euristikës së:

- A. Ankorimit dhe përshtatjes
- B. Përshtatjes
- C. Përfaqësimit
- D. Simulimit

Pyetja 41.

Radha e lindjes djalë-vajzë-djalë-vajzë është më përfaqësuese për dukuritë e zakonshme, sesa djalë-djalë-djalë. Ky lloj arsytimi social lidhet me Euristikën e:

- A. Ankorimit dhe të përshtatjes
- B. Përfaqësimit
- C. Përshtatjes
- D. Simulimit

Pyetja 42.

Qëndrimi korrespondon me sjelljen kur:

- A. Kriteret e tyre nuk korespondojnë në nivelin e specifikimit
- B. Kriteret e tyre korespondojnë mirë në nivelin e specifikimit
- C. Qëndrimi i individit nuk mund të transformohet në sjellje
- D. Të menduarit për qëndrimin dhe sjelljen nuk bazohen në njohje

Pyetja 43.

Moskonformisti refuzon të konformohet kur:

- A. Është dakort me shumicën
- B. Inkurajohet nga mjedisi
- C. Ka vetvlerësim të ulët
- D. Ka besim dhe pavarësi në gjykime

Pyetja 44.

Koalicioni social e influencon më lehtë grupin, sesa një njeri i vetëm, sepse:

- A. Presioni ndaj njëshit është tepër i vogël në krahasim me presionin social ndaj dy vetëve
- B. Sa më i madh të jetë koalicioni i pakicës, aq më i mundshëm është ndikimi tek shumica
- C. Sa më tepër rritet numuri i pakicës, aq më shumë do të rritet edhe numuri i shumicës
- D. Sa më shumë rritet forca e shumicës, aq më shumë rritet forca e koalicionit të pakicës.

Pyetja 45.

Një nga teknikat më të sukseshme të komplaincës është:

- A. Euristika
- B. Ingratacioni
- C. Konformizmi
- D. Unanimiteti

Pyetja 46.

Cili nga formulimet më poshtë për racizmin është i gabuar:

- A. Në racizmin e sotëm kanë evoluar mënyrat e shprehjes së qëndrimeve
- B. Qëndrimet racore mund të maten shumë mirë me teknika indiferente
- C. Qëndrimet dhe paragjykimet racore shfaqen edhe në forma indirekte
- D. Racizmi nuk është një qëndrim paragjykes dhe sjellje diskriminuese

Pyetja 47.

Faktori më i rëndësishëm që stimulon konfliktin social midis brezave lidhet shumë me:

- A. Dallimet socialpsikologjike midis brezave
- B. Rritjen e mirëqënies sociale të njerëzve
- C. Shkallën e zhvillimit të vet shoqërisë
- D. Tranzicionin social që kalon shoqëria

Pyetja 48.

Motivi kryesor që i shtyn njerëzit në veprime altruiste është:

- A. Dëshira për të sakrifikuar kohën
- B. Egoizmi i shprehur i personit
- C. Empatia dhe reciprociteti
- D. Stresi dhe mungesa e kompetencës

Pyetja 49.

Në alternativat më poshtë, gjej citimin e gabuar. Norma e reciprocitetit:

- A. Aplikohet vetëm në marrëdhëniet midis të barabartëve
- B. Është një normë e njohur me përmasa universale
- C. Kushtëzon shumë sjellje të individit në shoqëri
- D. Stimulohet nga intituacione të ndryshme të shoqërisë

Pyetja 50.

Faktori final në modelin bazë të shkëmbimeve sociale është:

- A. Barazia
- B. Investimi
- C. Niveli krahasues
- D. Shpërblimi

Pyetja 51.

Faktori qëndror situativ që motivon agresivitetin është:

- A. Frustracioni
- B. Instikti i agresionit
- C. Imitimi
- D. Rrethana kërcënuese

Pyetja 52.

Sipas Hall-it, distanca nga 50 cm deri në 1,5 m emëtohet Distancë:

- A. Intime
- B. Personale
- C. Publike
- D. Sociale

Pyetja 53.

Cila do të ishte Distanca më e preferueshme që është mirë të mbani ndaj një personi që e takoni për herë të parë?

- A. Intime
- B. Personale
- C. Publike
- D. Sociale

Pyetja 54.

Cili nga pohimet e mëposhtme është i gabuar?

- A. Kur ndeshemi fillimisht me një zhurmë, ne stresohemi, ndërsa më pas, përshtatemi
- B. Në kushtet e zhurmës, njerëzit ka më pak të ngjarë që të ndihmojnë njeri-tjetrin
- C. Zhurma nuk ndikon konkretisht në sjelljen prosociale dhe antisociale të individit
- D. Zhurmat stresuese mund të ndikojnë në sjelljen tonë edhe pasi nuk i dëgjojmë më

Pyetja 55.

Fenomeni i mbipopullimit ka të bëjë me:

- A. Ndjenjën psikologjike të mospasjes së hapësirës personale
- B. Ndjenjën psikologjike të pushtimit të hapësirës së mjaftueshme
- C. Ndjenjën psikologjike të mospasjes së distancës së duhur intime
- D. Sipërfaqen që disponohet nga një numur i dhënë individësh

3. MOTIVACION

Pyetja 1.

Cila nga teoritë e mëposhtme mbi motivacionin bazohet në proceset e brendshme të njerëzve?
Teoria:

- A. Homeostatike
- B. Humaniste
- C. Pritjes
- D. Shtysës

Pyetja 2.

Cila nga teoritë e mëposhtme motivacionale ka më pak lidhje me ndryshimet individuale të sjelljes? Teoria:

- A. E nxitshmërisë
- B. Homeostatitke
- C. Hedonistike
- D. Instiktive

Pyetja 3.

Cili nga termat e mëposhtëm nuk ka të bëjë me motivacionin?

- A. Drejtimi i sjelljes
- B. Inteligjenca
- C. Nxitja
- D. Qëndueshmëria

Pyetja 4.

Cilën nga sjelljet e mëposhtme e ka më të vështirë ta spiegojë Teoria instiktive?

- A. Dëshirën për të ngrënë diçka, kur ndiejmë erën e mishit të pjekur
- B. Dëshirën seksuale të çastit
- C. Gërryrjen në stomak, kur na merr uria
- D. Kërkimin e ndijimeve të forta

Pyetja 5.

Teoria e impulsit ka në themel të saj idenë se trupi njerëzor:

- A. Bën ato sjellje që mendja e njeriut i do
- B. Kërkon të ruajë homeostazën brenda vetes
- C. Komandohet nga impulse të pavetëdijshme
- D. Kërkon një nivel nxitshmërie që të ndjehet rehat

Pyetja 6.

Kur njeriu humbet shumë lëngje, ai ka etje. Etja që na shtyn të pimë, është një motiv:

- A. Biologjik
- B. I mësuar
- C. I pavetëdijshëm
- D. Stimulus

Pyetja 7.

Njerëzit bëhen keq kur i kritikojnë. Ky fakt i marrëdhënieve ndërnjerëzore ka të bëjë me nevojat:

- A. Fiziologjike
- B. Për t'u ndierë të sigurt
- C. Për përkatësi dhe dashuri
- D. Për vetvlerësim

Pyetja 8.

Mund të vihet re se disa njerëz brejnë thonjtë e duarve. Kur u vihet në dukje kjo gjë, ata heqin dorë, por, pak më vonë, fillojnë t'i brejnë përsëri. Me se spiegethet një sjellje e tillë? Me:

- A. Sjellje që janë kryesisht të mësuara
- B. Impulsin e brendshëm për të brejtur
- C. Nevojën për të vendosur homeostazën
- D. Kënaqësinë e shkaktuar nga brejtja

Pyetja 9.

Disa herë prindërit ua shajnë të rinjve shokët që kanë. Por të rinjtë nuk i braktisin ata. Ky veprim i tyre spiegethet më mirë me nevojën për:

- A. Përkatësi
- B. Vetvlerësim
- C. Vetaktualizim
- D. Siguri

Pyetja 10.

Sipas Maslowt, shkalla më e lartë e motivacionit që mund të arrijë njeriu është:

- A. Aftësia për të vlerësuar vetveten
- B. Energjia për të siguruar të mira materiale
- C. Prirja për t'u lidhur me njerëzit e tjerë
- D. Prirja për të realizuar potencialin personal

Pyetja 11.

Një njeri i etur për sukses, ndër aktivitetet e mëposhtme, do të preferonte një punë:

- A. Për të cilën nuk di nëse do të ketë sukses apo jo
- B. Për të provuar realisht synimet e tij
- C. Të vogël, por me sukses të garantuar
- D. Të vështirë, sukcesi i të cilës varet nga aftësitë e tij

Pyetja 12.

Ndëshkimi është më efektiv kur ai:

- A. Bëhet menjëherë pasi ka ndodhur sjellja e padëshiruar
- B. Bëhet para se të ndodhë një sjellje e padëshiruar
- C. Është gjithmonë shumë i ashpër dhe i pakontrolluar
- D. Nuk ushtrohet në mënyrë vazhduar ose sistematike

Pyetja 13.

Nëse do të ngelnit i vetmuar në një vend të huaj për një kohë të gjatë, cilin rend të nevojave të mëposhtme do të zgjidhni për plotësim:

- A. Fiziologjike, përkatësi, siguri, vetaktualizim, vlerësim
- B. Fiziologjike, siguri, përkatësi, vlerësim, vetëaktualizim
- C. Siguri, vetaktualizim, përkatësi, fiziologjike, vlerësim
- D. Vlerësim, siguri, fiziologjike, vetaktualizim, përkatësi

Pyetja 14.

Njëri prej qëndrimeve të mëposhtme të mësuar nga eksperiencia sociale, nuk i përket grupit prej 20 motiveve të hartuara nga Henry Murray. Në alternativat më poshtë, zgjidh cili është ky:

- A. Aderimi
- B. Agresioni
- C. Atashimi
- D. Autonomia

Pyetja 15.

Midis pohimeve të mëposhtëm, zgjidhni pohimin e saktë:

- A. Agresiviteti është i lindur, prandaj në shfaqjen e motivit të agresionit, mjedisi social nuk luan ndonjë rol me rëndësi.
- B. Kur motivi për siguri është shumë i fortë, njerëzit përpiqen të kenë një jetë aktive, plot të reja dhe ndryshime.
- C. Motivi për të arritur standarde, na shtyn drejt sjelljeve që janë në përputhje me standardet tona të brendshme.
- D. Motivi për fitim dhe pasuri, çon gjithmonë në kryerje të veprimeve devijante, në shkelje të normave morale ose ligjore.

Pyetja 16.

Cili nga termat e mëposhtëm lidhet më tepër me konceptin e sotëm të motivimit?

- A. Mekanizëm lëvizës
- B. Përpjekje e brendësuar
- C. Teknikë vepruese
- D. Teknikë ndikuese

Pyetja 17.

Aftësi të qëndrueshme individuale, zotësi, besim në vetvete, siguri, motivim i vazhdueshëm për punën dhe karrierën. Këto janë disa nga treguesit që lidhen me:

- A. Kompetencën
- B. Pushtetin
- C. Ruajtjen e prestigjit
- D. Suksesin

Pyetja 18.

“Fatkeqi parapëlqen shoqëri fatkeqësh”. Kjo thënie e vjetër ilustron më së miri motivin:

- A. E kuriozitetit
- B. E atashimit
- C. E vetëvrasjes
- D. Për siguri

Pyetja 19.

Një person i motivuar fort për sukses, ka shumë mundësi të vërë kërkesa të:

- A. Larta ndaj vetes; kërkesa të ulëta ndaj të tjerëve
- B. Larta ndaj vetes, kërkesa të larta ndaj të tjerëve
- C. Mesatare ndaj vetes; kërkesa të larta ndaj të tjerëve
- D. Ulëta ndaj vetës; kërkesa të larta ndaj të tjerëve

Pyetja 20.

Në alternativat e mëposhtme, gjej pohimin e gabuar lidhur me shpërblimet. Shpërblimet:

- A. Janë një teknikë e mirë për psikologët dhe mësuesit për të ndikuar veprimtaritë
- B. Janë efektive kur u jepen në mënyrë të rregullt pjesëmarrësve në një veprimtari
- C. Janë një stimul i jashtëm që i nxit pjesëmarrësit në një veprimtari konkrete
- D. Përdoren për të rritur motivimin e brendshëm të pjesëmarrësve në veprimtari

Pyetja 21.

Shprehjen “*gjq i brendshëm*”, ne e përdorim shpesh kur jemi duke iu referuar:

- A. Frustrimit
- B. Hierarkisë së motiveve
- C. Luftës së motiveve
- D. Zhgënjimit

Pyetja 22.

Cili nga pohimet lidhur me fazën pasveprimore të procesit motivues nuk është i vërtetë? Në fazën pasveprimore individi:

- A. Arrin gjithmonë rezultatet e dëshiruara dhe nuk ka dyshime
- B. Fillon të përjetojë rezultatet e projektuara dhe bën vlerësime
- C. Mund ta ndërpresë veprimtarinë dhe rishqyrton qëllimet e veta
- D. Provon mjaft emocione nga vlerësimi i suksesit dhe i arritjeve

Pyetja 23.

Për fazën e përcaktimit të qëllimit, gjatë procesit motivues, është e vërtetë që individi:

- A. Ndihet i qetë shpirtërisht, sepse ka përcaktuar qëllimin
- B. Nuk ka dyshime dhe përjetime konflikti të brendshëm
- C. Përvijon rrugën dhe mënyrat për të arritur qëllimin
- D. Përcakton veprimet konkrete për të arritur qëllimin

Pyetja 24.

Kurioziteti është motiv:

- A. Biologjik
- B. Hedonistik
- C. I mësuar
- D. Stimulues

Pyetja 25.

Motivi për sukses është motiv:

- A. Biologjik
- B. I mësuar
- C. I pavarur
- D. Stimulues

Pyetja 26.

Sipas studiuesve, qëndrimet mund të paraqiten në disa dimensione ose përmasa. Cili nga çiftet e qëndrimeve më poshtë nuk është i saktë?

- A. Fetare dhe religjioze
- B. Humane dhe johumane
- C. Liberale dhe konservatore
- D. Progresive dhe regresive

Pyetja 27.

Gjej formulimin e gabuar lidhur me natyrën e qëndrimeve. Motivet:

- A. Edhe e stimulojnë edhe e frenojnë sjelljen
- B. Frenojnë veprimet dhe sjelljen e individit
- C. Janë kryesisht të lindura dhe jo të mësuara
- D. Stimulojnë veprimet dhe sjelljen e individit

Pyetja 28.

E veçanta në Teorinë motivacionale të Frojdit është se ai e quan *energjinë trupore* si energji:

- A. E libidos
- B. Konstante
- C. Me sistem të mbyllur
- D. Të ndryshme tek çdo individ

Pyetja 29.

Kontributi kryesor në Teorinë e nevojave të Masllowut është se ai:

- A. Identifikon disa grupe motivesh
- B. I quan motivet “më të vogla,, dhe “më të mëdha,,
- C. Nuk e identifikon motivin si të vetëm
- D. Ndërtoi një piramidë të hierarkisë së nevojave

Pyetja 30.

Autori i Teorisë motivacionale të ekspektacion-vlerës është:

- A. Heider
- B. Mc Clelland
- C. Rotter
- D. Tolman

Pyetja 31.

Obeziteti është çrregullim i motivit të urisë që lidhet më tepër me probleme:

- A. Dietetike
- B. Genetike
- C. Mendore
- D. Metabolike

Pyetja 32.

E veçanta e motivacionit seksual është se ai:

- A. Është motiv parësor
- B. Nuk rrezikon mbijetesën
- C. Provokon kënaqësi
- D. Rrezikon mbijetesën

Pyetja 33.

Gjej formulimin e gabuar. Motivacioni seksual:

- A. Është një nevojë biologjike
- B. Krijon shumë probleme të sjelljes
- C. Nuk lidhet me sjellje të mësuara
- D. Orienton mjaft sjellje të individit

Pyetja 34.

Në sjelljen seksuale të individit është e ndaluar:

- A. Dominanca
- B. Incesti
- C. Homoseksualizmi
- D. Masturbimi

Pyetja 35.

Gjej alternativën e gabuar. Nevoja për atashim rritet tek individit nga:

- A. Prezenca e të tjerëve
- B. Prezenca e stresit
- C. Të qenit i pavarur
- D. Të qenit inferior

Pyetja 36.

Sjellja agresive është më tepër:

- A. E lindur dhe jo aq e mësuar
- B. E mësuar sesa e lindur
- C. Mekanizëm mbrojtës i personalitetit
- D. Sjellje e lindur dhe e paevitueshme

Pyetja 37.

Në realitetin shqiptar, motivi i vetvrasjes është më tepër i ndikuar nga:

- A. Abuzimi me substancat
- B. Emisionet televizive
- C. Kohezioni dhe ndryshimet sociale
- D. Mungesa e ndihmës ndaj individit

Pyetja 38.

Lufta e motiveve cilësohet si një “gjqy i brendshëm,,. Nëse kemi parasysh këtë përcaktim, cila nga alternativat më poshtë është e saktë? Pra, lufta e motiveve është:

- A. Ligjësi e procesit motivacional
- B. Mbimotivacion individual
- C. Nivel optimal i motivimit
- D. Paaftësi e vendimmarrjes

Pyetja 39.

Cila nga alternativat e mëposhtme, nuk është ligjësi e procesit motivacional:

- A. Deprivacioni
- B. Hedonizmi
- C. Satiacioni
- D. Vlerësimi i qëllimit

Pyetja 40.

Nëse kemi parasysh Fazën pasveprimore të procesit motivues, kjo fazë, në vetvete, shënon:

- A. Arritjen e kënaqësisë
- B. Nxitjen për të vepruar
- C. Reflektim ndaj veprimit të kryer
- D. Satiacionin individual

Pyetja 41.

Në dhënien e konceptit për motivimin, ndër alternativat më poshtë, gjej formulimin e gabuar. Motivimi është më tepër:

- A. Arritje e sjelljes dhe qëllimeve të dëshiruara
- B. Bindje dhe ndërgjegjësim i individit për të vepruar
- C. Teknikë për të motivuar veten dhe të tjerët
- D. Thjesht, çlirim i energjive trupore për të vepruar

Pyetja 42.

Nëse kemi parasysh raportin midis sjelljeve instiktive dhe atyre të mësuara, sipas Epstein, cila nga alternativat më poshtë është më e saktë? Sjellja e motivuar:

- A. Është kryesisht e vetëdijshme
- B. Është e drejtuar nga qëllime të paramenduara
- C. Nuk është e ndikuar nga rrethanat
- D. Nuk është e lidhur me kushtëzimin

Pyetja 43.

Ne themi se një individ është i motivuar së brendshmi kur:

- A. Interesat personale rregullojnë sjelljen
- B. Kryen veprime që nuk i pëlqejnë
- C. Kryen sjellje të dëshiruara prej tij
- D. Veprimet e tij janë argëtuese e shpërblyese

Pyetja 44.

Studiuesit e motivimit e përcaktojnë autonominë si:

- A. Aktivitet individual i qëllimshëm
- B. Rregullim të brendësuar të sjelljes
- C. Proces për të arritur synimet
- D. Zgjim të ndërgjegjes individuale

Pyetja 45.

Njerëzit pajtohen me një kërkesë që vjen nga jashtë, por kjo, fillimisht, është pjesërisht e brendësuar, pasi mbështetet nga kërcënimi i ndjesive të fajësisë dhe të turp-it, nëse ajo nuk plotësohet. Në një situatë të tillë, kemi të bëjmë me motivim:

- A. Autonom
- B. Të integruar
- C. Të brendshëm
- D. Të jashtëm

Pyetja 46.

Nëse individët ndihen të paafte për të arritur një qëllim të caktuar, ose për të iniciuar një sjellje, ata nuk janë të prirur që të përpiqen për ta bërë këtë gjë. Në vështirimin motivacional, kjo dukuri quhet:

- A. Demotivim
- B. Motivim autonom
- C. Tension i brendshëm

D. Sjellje e padrejtuar

Pyetja 47.

Daniel Pink, thotë se gjatë punës, është vërtet e habitshme ajo që na motivon. Sipas tij, motivimi i vërtetë rrjedh nga dëshira për të:

- A. Bërë gjëra në shërbim të vetes
- B. Kënaqur më tepër veten
- C. Mos e drejtuar vetë jetën
- D. Përmirësuar kushtet e punës

Pyetja 48.

Ndër alternativat e mëposhtme, gjej alternativën e gabuar. Që individi të provojë gjendjet psikologjike bazë që burojnë prej punës së tij, duhet të:

- A. Kuptojë se cilat janë rezultatet e punës së tij
- B. Mos ketë dëshirë dhe pritshmëri të larta
- C. Ndjejë në vetvete se puna e tij ka kuptim
- D. Ndjejë përgjegjësi për punën që kryen

Pyetja 49.

Ndër alternativat më poshtë, gjej atë që është e gabuar. Sipas McClelland, nevoja për arritje gjatë punës është e lidhur me disa kërkesa, që individët i vënë para vetes. Kështu, ata:

- A. Duan të kenë gjithçka nën kontroll
- B. Parapëlqejnë rrezikshmëri të moderuar
- C. Vënë mbi gjithçka shansin apo rastësinë
- D. Shmangin ato detyra që i quajnë si të lehta

Pyetja 50.

Efektet motivuese të shpërblimeve gjatë punës janë studiuar nga psikologët sociale dhe ata të motivacionit. Ato nuk japin efektin e tyre më të mirë kur:

- A. Jepen në kohën e duhur
- B. Jepen në masën e duhur
- C. Kthehen si qëllim në vetvete
- D. Kombinohen me stimuj të tjerë

Pyetja 51.

Sipas studiuesve të motivacionit, gjatë të nxënimit, motivi për sukses varet nga:

- A. Frika nga dështimi
- B. Nevoja për sukses
- C. Përpjekjet sistematike
- D. Pritshmëritë

Pyetja 52.

Sjellja e mësuesit quhet mbështetëse për nxënësit, kur mësuesi:

- A. Detyron nxënësit të ndjekin kurse private
- B. Inkurajon drejt nxënësit gjatë të nxënit
- C. Krijon vështirësi artificiale para nxënësve
- D. Krijon distancë në komunikim me nxënësit

Pyetja 53.

Sipas Thorndike, ka disa mënyra për të përmirësuar ndëshkimin. Ndër to, më produktive është të:

- A. Kërkosh mënyra të zgjuara për të arritur sjelljen e dëshiruar
- B. Ndryshosh shpesh theksin gjatë komunikimeve me nxënësit
- C. Përdorësh ndëshkimin në mënyrë të vazhduar e sistematike
- D. Përgatitesh në mënyrë perfekte për të kontrolluar sjelljen

Pyetja 54.

Lavdërimi i sjelljes së nxënësit nga mësuesi është më efektiv kur:

- A. I jepet një nxënësi vazhdimisht dhe pa shpërblim
- B. Përdor kritere të barabarta për arritje të ndryshme
- C. Përdoret në mënyrë krejtësisht të rastësishme
- D. Shpërblen arritje të nxënësit në detyra specifike

4. INTELIGJENCA EMOCIONALE

Pyetja 1.

Inteligjenca emocionale është:

- A. E njëjtë me inteligjencën artificiale
- B. E njëjtë tek meshkujt dhe femrat
- C. Formë e inteligjencës sociale
- D. Me koeficient më të lartë

Pyetja 2.

Aspekti më i rëndësishëm i Inteligjencës emocionale është:

- A. Komunikimi me të tjerët
- B. Ruajtja e ekuilibrit emocional
- C. Të qenit optimist në jetë
- D. Të qenit empatik ndaj të tjerëve

Pyetja 3.

Sipas studiueseve të Inteligjencës emocionale, tipari kryesor i saj lidhet me:

- A. Aftësinë për t'u lidhur me të tjerët
- B. Aftësitë individuale për të përballuar problemet
- C. Kënaqësinë e jetës individuale
- D. Përshtatjen e individit ndaj stimujve

Pyetja 4.

Termi *inteligjencë emocionale* ka të bëjë me:

- A. Aftësinë për të monitoruar ndjenjat dhe emocionet tek vetja dhe të tjerët
- B. Përpjekjen për t'u mësuar kompjuterave të mendojnë si mendon njeriu
- C. Përpjekjen e individit për t'u hequr më i zgjuar nga ç'është në të vërtetë
- D. Të mësuarit për të zgjidhur problemet në jetë, ashtu siç bën kompjuteri

Pyetja 5.

Cili nga grupet e autorëve ka dhënë kontribut kryesor në zhvillimin e Teorisë mbi inteligjencën emocionale?

- A. P. Salovey dhe D. Goleman
- B. S. Schachter dhe R. Zajonc
- C. W. James dhe C. Lange
- D. W. Cannon dhe Ph. Bard

Pyetja 6.

Studiuesit e Inteligjencës emocionale kanë përcaktuar 4 fusha kryesore të saj. Cila nga alternativat më poshtë nuk bën pjesë në këto fusha:

- A. Ekspresioni emocional
- B. Lehtësimi i mendimeve
- C. Menaxhimi i emocioneve
- D. Perceptimi emocional

Pyetja 7.

Menaxhim emocional do të thotë të kesh dhe të zhvillosh aftësinë për të:

- A. Kuptuar dhe rregulluar emocionet tek vetja dhe të tjerët
- B. Kuptuar ndjenjat dhe ndjesitë tek vetja dhe tek të tjerët
- C. Njohur emocionet që janë të njejta tek vetja dhe tek të tjerët
- D. Njohur emocionet që janë të ndryshme tek vetja dhe tek të tjerët

Pyetja 8.

Lehtësim emocional i mendimeve do të thotë të kesh aftësinë për të:

- A. Procesuar dhe përdorur drejt informacionin emocional
- B. Llidhur sa më shumë emocionet me operacionet mendore
- C. Ulur sa më shumë efektin e emocioneve në arsyetim
- D. Rritur përfshirjen e emocionet në zgjidhjen e problemeve

Pyetja 9.

Ndër alternativat më poshtë, gjej të gabuarën. Studiuesit theksojnë se Inteligjenca emocionale është shumë më tepër se sjellja e bukur ndaj të tjerëve, prandaj ata e vlerësojnë emocionin si burim:

- A. Agresiviteti
- B. Energjie
- C. Informacioni
- D. Kreativiteti

Pyetja 10.

Ndër alternativat më poshtë, gjej formulimin e gabuar. Meshkujt me inteligjencë të lartë emocionale janë:

- A. Më të ndrojtur dhe anojnë nga brengosja
- B. Më besnikë ndaj njerëzve dhe ideve
- C. Më të ekuilibruar emocionalisht
- D. Të shoqëruar dhe të hapur me të tjerët

Pyetja 11.

Ndër alternativat më poshtë, gjej formulimin e gabuar. Femrat emocionalisht inteligjente janë:

- A. Me mendime tepër pozitive për veten
- B. Më të gjalla dhe tepër të çiltra se të tjerët
- C. Me gjendje stresante që i kapërcejnë lehtë
- D. Oratore dhe i shprehin hapur ndjenjat e tyre

Pyetja 12.

Ndër alternativat më poshtë, gjej atë që është më e saktë. Njohuritë për Inteligjencën emocionale na duhen për të:

- A. Njohur çrregullimet emocionale tek vetja
- B. Rritur tej mase efektivitetin e të nxënit
- C. T'u përfshirë më tepër në programe trajnuese
- D. Zbuluar kontributin që jep në cilësinë e jetës

Pyetja 13.

Sipa studiuësve, qëllimi final i Inteligjencës emocionale është:

- A. Arritja e një kontrolli të mirë
- B. Shtypja e emocioneve
- C. Shkurtimi i kohës së zgjatjes
- D. Shprehja e pakontrolluar

Pyetja 14.

Ndër alternativat më poshtë gjej formulimin e gabuar. Ndërhyrja e individit për të modifikuar situatën që shkakton emocionin quhet strategji e Koppingut që përqëndrohet mbi:

- A. Emocionin tek vetja
- B. Emocionit tek të tjerët
- C. Reagimin ndaj stimujve
- D. Situatën konkrete

Pyetja 15.

Hap i rëndësishëm në rrugën e rritjes së vetëdijes emocionale është të:

- A. Largohehi gjithmonë nga situatat e rrezikshme
- B. Pakësojmë sa më shumë spektrin e informacionit
- C. Reagojmë sa më shumë në mënyrë agresive
- D. Zgjerojmë sa më shumë spektin e informacionit

Pyetja 16.

Sipas studiuësve, në shumicën e rasteve, mungesa e vetkontrollit ndaj ndjenjave dhe emocioneve vjen nga pavetëdija. Për këtë:

- A. Nga që e kemi të vështirë, të ulim kujdesin për emocionet
- B. Të shmangim çdo pyetje që mund të na lindë në çast

- C. Të kemi një sasi të sistemuar informacioni në vetëdijen tonë
- D. Të kuptojmë cilat emocione përsëriten më shpesh tek vetja

Pyetja 17.

Gjëja e parë që duhet të bëjë çdo njeri për menaxhimin efiikas të emocioneve personale është të:

- A. Kuptojë nëse emocionet e paralizon sjelljen
- B. Komprometojnë sensin e vetëshprehjes
- C. Njohë në thellësi eksperiencën emocionale
- D. Qortojë veten dhe të fillojë të reflektojë

Pyetja 18.

Ndër alternativat më poshtë, gjej atë që është e gabuar. Për një kontroll më të mirë të emocioneve tona duhet të jemi më:

- A. Kërkues për rezultate më të mira në provat e suksesit
- B. Pak impulsivë dhe më shumë kontrollues ndaj vetes
- C. Shumë indiferentë ndaj situatave stresante
- D. Të përgjegjshëm ndaj vetes në situata kritike

Pyetja 19.

Këshilla më e keqe për menaxhimin e emocioneve vetjake do të ishte:

- A. Kultivo më pak ndjesi pozitive për veten dhe për punën
- B. Mëso të trajtosh më mirë gjendjet stresante tek vetja
- C. Përpiqu të reduktosh sa më shumë vetminë dhe ankthin
- D. Zvogëlo numurin e ofendimeve verbale dhe dhunën

Pyetja 20.

Ndër alternativat më poshtë, gjej atë që nuk është e saktë. Prej shumë vitesh, studiuesit kanë ditur se empatia kontribuon në suksesin profesional të të punësuarve. Për këtë, kanë segjeruar që këta duhet të:

- A. Jenë të sukseshëm jo vetëm në punë, por dhe në jetën sociale
- B. Kuptojnë se personat me sjellje josociale janë më pak empatikë
- C. Reduktojnë aftësinë për të përshkruar emocionet tek vetja
- D. Zhvillojnë aftësinë për të identifikuar emocionet e të tjerëve

Pyetja 21.

Kushti parësor për menaxhimin me sukses të marrëdhënieve ndërpersonale qëndron në aftësinë e individit për të:

- A. Dalluar sjelljen e të tjerëve nga interpretimet që bëhen për të
- B. Kërkuar më tepër ndihmë të sinqertë tek të tjerët
- C. Shprehur vazhdimisht para të tjerëve vështirësitë veti
- D. Zëvendësuar sjelljet agresive me sjellje të përshtatshme

Pyetja 22.

Meqë çdo emocion ka skemën e tij karakteristike trupore, vetëdija e trupit tonë zhvillohet kur:

- A. Individit arrihet ta njohë atë
- B. Ka imazh pozitiv për veten
- C. Ndihet i qetë me vetveten
- D. Ushtron kontroll sistematik ndaj saj

Pyetja 23.

Eksperiencat e para emocionale të fëmijës formohen nga qëndrimet e prindërve, kur këto janë më tepër:

- A. Indiferente
- B. Mbështetëse
- C. Mospërfillëse
- D. Tolerante

Pyetja 24.

Ndër alternativat më posht, gjej formulimin më të saktë. Fëmija rritet i shëndetshëm emocionalisht kur:

- A. Krahason veten me të tjerët, si i ndërtojnë ata marrëdhëniet me të
- B. Përpiqet të reagojë dhe të shprehë lirshëm atë që percepton
- C. Qortohet dhe inkurajohet me metoda specifike për qëndrimin ndaj të tjerëve
- D. Tek ai nuk vihen në lëvizje qysh herët në moshë ndjesitë e para ndaj vetes

Pyetja 25.

Çfarë nuk u këshillohet prindërve në qëndrimin e tyre ndaj fëmijëve. Ata duhet të:

- A. Jenë të hapur dhe të diskutojnë për probleme të ndryshme
- B. Krijojnë në familje një jetë të qetë dhe pa probleme
- C. Lejojnë fëmijën të vishet e rregullohet siç i pëlqen
- D. Përdorin krahasime me figura jo të përshtatshme për ta

Pyetja 26.

Studiuesit theksojnë se zhvillimi i Inteligjencës emocionale dhe përsosja e përvojave emotive mund të vijë duke:

- A. Kultivuar aftësinë për vetshprehje dhe vetbesim
- B. Lenë të lirë çdo qëndrim e sjellje të fëmijës
- C. Përfshirë më shumë të rriturit në nxitjen e fëmijëve
- D. Shtuar shoqërinë me moshatarët dhe njerëz të tjerë

Pyetja 27.

Ndër alternativat më poshtë, gjej formulimin e gabuar. Fëmijët me çrregullime emocionale:

- A. Bëhen më të tërhequr nga problemt sociale
- B. E kalojnë kohën me fëmijë problematikë
- C. Kanë probleme në përqëndrimin e vëmendjes
- D. Nuk kanë probleme në të menduarin e tyre

Pyetja 28.

Sjellja delikvente është më tepër produkt i:

- A. Çrregullimit emocional
- B. Faktorëve socialë
- C. Ndrydhjes së individit
- D. Paftësisë për kontroll

Pyetja 29.

Gjej alternativën e gabuar. Traummat fëmijënore janë gjendje psikologjike të rënda dhe të vështira që karakterizohen nga:

- A. Humbje e ekuilibrit psikik
- B. Rritje e vetëdijes individuale
- C. Humbje e vazhduar oreksit
- D. Zhgënjim dhe humbje e besimit

Pyetja 30.

Cila është alternativa e gabuar? Dhuna ndaj fëmijëve:

- A. Ka pasoja për sjelljen e fëmijës në të ardhmen
- B. Kultivon frikën dhe ndrydhjen sistematike
- C. Ndikon në rritjen dhe tiparet fizike të fëmijëve
- D. Nuk ka efekte në rritjen dhe zhvillimin normal

Pyetja 31.

Duke u përpjekur për të spjeguar se si emocionet marrin pjesë në procesin e të nxënësit, Demetrio (një studiues i emocioneve) flet për një cikël emocional që kalon nëpër katër faza. Cila nga këto faza nuk është e formuluar prej tij?

- A. Çudia ose mahnitja
- B. Pritja e shpërblimit
- C. Shprehja e ndjenjave dhe përforcimi
- D. Shkëputja nga emocioni i përjetuar

Pyetja 32.

Ndër nxënësit e mëposhtëm, më inteligjent është ai që:

- A. Është këmbëngulës e sistematik.
- B. Edhe është i zgjuar, edhe punon.
- C. E ka KI mbi mesataren.
- D. Ia pret dhe nuk studion shumë

Pyetja 33.

Frojdi theksonte se traumat fëmijore në përqindjen më të madhe e kanë shkakun në:

- A. Adoleshencë
- B. Fëmijërinë e hershme
- C. Foshnjëri
- D. Rininë e hershme

Pyetja 34.

Shkaku kryesor pse të rinjtë përdorin rregullisht substanca të tilla si nikotinë, alkool, drogë e të tjera është:

- A. Instikti i shkatërrimit
- B. Krijimi i varësisë psikologjike
- C. Përballimi i stresit
- D. Veçoritë e personalitetit

Pyetja 35.

Ndër alternativat më poshtë, gjej atë që është më e saktë. Kur truri ynë pushtohet nga emocione intensive pozitive:

- A. Aftësitë konjitive bëhen më produktive, por edhe mund të bien
- B. Aftësitë e të kuptuarit dhe vëmendja mund të kufizohen tej mase
- C. Aftësitë konjitive çoroditen dhe mund të dalin jashtë kontrollit

D. Tek individi nuk mund të aktivizohet më sjellja inteligjente

Pyetja 36.

Ideja se emocionet janë gjendje të pakontrollueshme duhet të shoqërohet me bindjen se ato:

- A. Është e pamundur t'i kontrollosh, prandaj nuk duhen përpjekje
- B. Është e pamundur t'i kontrollosh, prandaj çdo gjë t'ia lemë rastësisë
- C. Diçka duhet bërë me vetëdije, që të arrish për t'i vënë nën kontroll
- D. Duhet shprehur plotësisht, për të ruajtur një shëndet të mirë mendor

Pyetja 37.

Në kohët moderne, shumë individë arrijnë të marrin vendimin për të përdorur drogën, duke qenë të ndikuar më tepër nga:

- A. Humbja e shoqërizimit
- B. Ndikimi i mjedisit social
- C. Ndikimi i mediave vizive
- D. Problemet ekonomike

Pyetja 38.

Gjatë punës edukative në shkolla, çdo mësues duhet të orientojë nxënësit si të drejtojnë në mënyrë produktive emocionet e tyre. Në këtë drejtim, të penguarit e tyre në plotësimin e disa kënaqësive është i lidhur me përpjekjet për të zhvilluar:

- A. Aftësitë njohëse
- B. Kuptueshmëri verbale
- C. Shkathtësi të sjelljes
- D. Shkathtësi emocionale

Pyetja 39.

Një nga treguesit e Inteligjencës emocionale lidhet me faktin nëse individi është në gjendje të bëjnë dallimin mes ndjenjave dhe veprimeve të tij. Ky veprim quhet:

- A. Menaxhim emocional
- B. Shkathtësi emocionale
- C. Shkathtësi e sjelljes
- D. Shkathtësi njohëse

Pyetja 40.

Në kënvështrimin e Inteligjencës emocionale, kontroll i impulsivitetit, arritje e qëllimeve, njohje e veprimeve, parashikim i pasojave e të tjera, quhet shkathtësi:

- A. Emocionale
- B. E sjelljes
- C. Motorike
- D. Njohëse

Pyetja 41.

Në këndvështrimin e Inteligjencës emocionale, paraqitje e qartë e kërkesave, largimi nga influencat negative, përgjigje e shkathtë ndaj kritikave, përpjekje për të ndihmuar të tjerët e tje. është shkathtësi:

- A. Emocionale
- B. E sjelljes
- C. Kontrolli
- D. Njohëse

Pyetja 42.

Këshillimi me nxënësit në shkolla është i sukseshëm kur:

- A. Këshillimi bëhet individualisht dhe me besim reciprok
- B. Nxënësi kupton se sjellja e keqe nuk është në interes të tij
- C. Nxënësit i lejohet të flasë vetëm për atë çka i kërkohet
- D. Nxënësi duhet të kuptojë vetëm pasojat e sjelljes së tij

Pyetja 43.

Në trajtimin e problemeve emocionale ka më tepër rëndësi të:

- A. Kuptohet rëndësia e Inteligjencës emocionale
- B. Trajtohet sa më herët çrregullimi emocional
- C. Zbulohet rritja e padukshme e adrenalinës
- D. Zbulohet dhe vlerësohet forca e emocioneve

Pyetja 44.

Ndër alternativat më poshtë, gjej formulimin e gabuar. Qëllimi kryesor i ndërhyrjeve të psikoterapistit ndaj çrregullimeve emocionale është:

- A. Çlirimi i pacientit nga iluzionet e kota
- B. Inkurajimi i vazhduar i pacientëve
- C. Ndërgjegjësimi për gjendjes emocionale
- D. Përballimi i gjendjeve të vështira

Pyetja 45.

Një nga mësimet që jep psikoterapia është të ndihmojë individët si të mposhtin në mënyrë të sukseshme ndjenjat negative tek vetja. Për këtë, për çdo individ është e rëndësishme:

- A. Edukimi emocional
- B. Lënia e çdo gjëje rastësisë
- C. Mbikqyrja e ndjenjave
- D. Zbutja e amigdalës impulsive

Pyetja 46.

Ndër alternativat më poshtë, gjej atë që është e saktë. Shkathtësitë emocionale:

- A. Janë kryesisht të trashëguara
- B. Nuk kanë vlerë për tërë jetën
- C. Përsosen me edukim të mirëfilltë
- D. S'kanë nevojë për rimësim

Pyetja 47.

Për trajtimin e traumave psikike, Dr. Herman përshkruan një metodë që kalon nëpër tre hapa. Cila nga alternativat më poshtë, nuk është pjesë e këtyre hapave:

- A. Dhënia e ndihmës
- B. Përfshirja e ritregimit në shërim
- C. Qetësimi fiziologjik
- D. Rikthimi i ndjenjës së sigurisë

Pyetja 48.

Sipas Zillman, shfryrja e zemërimit:

- A. Është një nga metodat më të këqia të qetësimit
- B. Është efikase në gjendjen e butë të zemërimit
- C. Ndihmon shumë në qetësimin e individit
- D. Shton edhe më tepër vetë zemërimin

Pyetja 49.

Studiuesit e Inteligjencës emocionale sugjerojnë disa mënyra konkrete për mënjanimin e zemërimit. Cila nga metodat më poshtë, nuk ndihmon në qetësimin e tij?

- A. Ballafaqimi direkt me personin tjetër
- B. Relaksimi i frymëmarrjes dhe muskujve
- C. Ushtrimet dhe aktiviteti fizik
- D. Vetmia deri sa individit të qetësohet

Pyetja 50.

Herry Levinson ka dhënë kontribut të veçantë, sidomos për mënyrat se si mund të:

- A. Mënjanohet tensioni emocional
- B. Bëhet kritika më efektive
- C. Bëhen kritikak në çift
- D. Inkurajojmë të tjerët

Pyetja 51.

Studiuesit e emocioneve kanë treguar disa rregulla kryesore të sjelljes emocionale, të cilat sipas tyre, mësohen më shumë përmes:

- A. Intuitës
- B. Instruksioneve
- C. Mesazheve indirekte
- D. Theksave të veçantë

Pyetja 52.

Këshilla më e mirë për të qetësuar grindjen në çift është:

- A. Dashuri dhe respekt
- B. Marrje përgjegjësie për rrethanën
- C. Shprehja e komplimentave
- D. Të kërkuarit vetëm falje

Pyetja 53.

Fuqia e oratorit, e politikanit, mësuesit, klerikut lidhen me faktin nëse ata, me emocionet e tyre ndikojnë të tjerët, duke harmonizuar sjelljen, lëvizjet trupore, gjestet, pranimin ose refuzimin e mesazheve e të tjera. Kjo mënyrë komunikimi quhet:

- A. Marrëdhënie e ndërsjelltë
- B. Reagim emocional
- C. Transmetim i emocioneve
- D. Sinkronizim emocional

Pyetja 54.

Aleksitimia, ose pamundësia për të shprehur emocionet vetiake përmes fjalëve dhe komunikimit joverbal është në vetvete:

- A. Çrregullim emocional

- B. Mungesë e inteligjencës
- C. Sëmundje psikike
- D. Sjellje normale

Pyetja 55.

Të heqësh dorë nga varësia prej alkoolit dhe substancave të tjera nuk është e lehtë. Për këtë, më e mirë dhe më rezultative është terapia:

- A. E besimit në vetvete
- B. Me medikamente
- C. Me ndihmë shoqërore
- D. Terapia psikologjike

Pyetja 56.

Optimizmin në mund ta përcaktojmë si gjendje:

- A. Emocionale me tonus të përgjithshëm të ngritur
- B. E lartë shpirtërore dhe kënaqësie e individit
- C. Produktive e Inteligjencës emocionale
- D. Shpirtërore individuale e të qenit i lumtur

PSIKOLOGJIA E STRESIT

Pyetja 1.

Me termin stres duhet të kihet parasysh:

- A) Një varg ndryshimesh biokimike
- B) Një varg ndryshimesh fiziologjike
- C) Një varg ndryshimesh psikologjike
- D) Një varg ndryshimesh psiko-sociale

Pyetja 2.

Të gjitha funksionet jetike në organizëm kontrollohen dhe rregullohen nga një strukturë e vogël trunore që quhet:

- A) Gjendra Pituitare
- B) Hipotalamusi
- C) Korteksi Adrenal
- D) Korteksi Cerebral

Pyetja 3.

Qëndra trunore e stresit është:

- A) Gjendra Pituitare
- B) Gjendra Tiroide
- C) Hipotalamusi
- D) Korteksi Cerebral

Pyetja 4.

Sistemi nervor autonom kontrollon funksionet e pavullnetshme të aktiviteteve jetike nëpërmjet dy seksioneve që janë:

- A) Seksione autonom dhe parasimpatik
- B) Seksione endokrin dhe parasimpatik
- C) Seksione endokrin dhe parasimpatik
- D) Seksione simpatik dhe parasimpatik

Pyetja 5.

Seksioni që e kthen trupin në gjëndje qetësie pas stresit dhe përpiqet të ruajë funksionet e trupit në nivel normal është :

- A) Seksioni autonom
- B) Seksioni parasimpatik
- C) Seksioni endokrin
- D) Seksioni simpatik

Pyetja 6.

Hormoni katekolamin, efektin nxitës për mobilizimin e rezervave të trupit gjatë një situatë stresante në krahasim me sistemin simpatik autonom e ka:

- A) 4 herë më shumë se sistemi simpatik autonom
- B) 6 herë më shumë se sistemi simpatik autonom
- C) 8 herë më shumë se sistemi simpatik autonom
- D) 10 herë më shumë se sistemi simpatik autonom

Pyetja 7.

Hormoni kortisol gjatë një situatë stresante ka si qëllim:

- A) Të rrisë sasinë e gjakut në organizëm
- B) Të rrisë sasinë e sheqerit në organizëm
- C) Të ul sasinë e sheqerit në organizëm
- D) Të ul sasinë e gjakut në organizëm

Pyetja 8.

Babai i teorisë së stresit është fiziologu kanadez:

- A) Adlous Huxley
- B) Burhus Skinner
- C) Hans Selye
- D) Harold Minden

Pyetja 9.

Sipas Hans Selye vdekjen e shkaktojnë stresorët e ashpër:

- A) Fiziologjikë
- B) Fizikë
- C) Psikologjikë
- D) Socialë

Pyetja 10.

Sëmundjet që shkakton stresi quhen ndryshe psikosomatike sepse janë me:

- A) Natyrë emocionale, që shkaktohen pjesërisht nga faktorë fizik dhe veçanërisht nga faktorë psikologjik
- B) Natyrë emocionale, që shkaktohen pjesërisht nga faktorë psikologjik dhe veçanërisht nga ato fizik
- C) Natyrë fizike, që shkaktohen pjesërisht nga faktorë psikologjik dhe veçanërisht nga faktorë emocional
- D) Natyrë psikologjike, që shkaktohen pjesërisht nga faktorë emocional dhe veçanërisht nga faktorë fizik

Pyetja 11.

Tensioni i gjakut është në nivel normal kur ndodhet në kufirin:

- A) 95/55
- B) 95/70
- C) 120/80
- D) 140/90

Pyetja 12.

Tensioni i lartë i gjakut është një nga produktet kryesore të stresit i cili njihet ndryshe si:

- A) Vrasës i heshtur i muskulit të zemrës
- B) Vrasës i heshtur i i organeve të trupit
- C) Vrasës i vetshkaktuar i organeve të trupit
- D) Vrasës i vetshkaktuar i muskulit të zemrës

Pyetja 13.

Ulçerat janë sëmundje psikosomatike të stresit të cilat shfaqen si :

- A) Plagë nekrotike të dhimbshme në muskujt skeletorë dhe muskujt e butë
- B) Plagë nekrotike të dhimbshme në membranën që mbështjell kyçin
- C) Plagë nekrotike të dhimbshme në membranën mukoze të aparatit tretës
- D) Plagë nekrotike të dhimbshme në muskujt e mureve të enëve të gjakut

Pyetja 14.

Migrena karakterizohet nga dhimbje koke e cila zakonisht zgjat:

- A) 2-3 orë
- B) 3-4 orë
- C) 4-5 orë
- D) 4-6 orë

Pyetja 15.

Astma është sëmundje psikosomatike e stresit që karakterizohet nga:

- A) Ngushtim i rrugëve të frymëmarrjes si pasojë e rritjes së sekrecioneve nga veprimi i substancave të jashtme irrituese
- B) Zgjerim i rrugëve të frymëmarrjes si pasojë e rritjes së sekrecioneve nga veprimi i substancave të brëndshme irrituese
- C) Ngushtim i rrugëve të frymëmarrjes si pasojë e rritjes së sekrecioneve nga veprimi i substancave të brëndshme irrituese
- D) Zgjerim i rrugëve të frymëmarrjes si pasojë e rritjes së sekrecioneve nga veprimi i substancave të jashtme irrituese

Pyetja 16.

Ankthi neurotik është:

- A) Frika ndaj një rreziku real që do ndodhë
- B) Frika ndaj një rreziku që pritet të ndodhë
- C) Frika e vazhdueshme për dukuri të ndryshme
- D) Frika e lidhur me një rrezik konkret dhe fizik

Pyetja 17.

Ankthi që reziston brenda nesh me anë të mendimeve, ideve, imazheve dhe shfaqet padashur në mendjen tonë njihet si:

- A) Frikë
- B) Vetmi
- C) Obsesion

D) Panik

Pyetja 18.

Mekanizmi mbrojtës, “*Mohim i realitetit*” nënkupton:

- A) Refuzimin e pavetëdijshëm të mendimeve, kujtime të pakëndshme
- B) Refuzimin e pavetëdijshëm të mendimeve, kujtimeve të këndshme
- C) Refuzimin për të perceptuar ose për tu marrë me gjëra të pakëndshme
- D) Refuzimin për të perceptuar ose për tu marrë me gjëra të këndshme

Pyetja 19.

Mekanizmi mbrojtës, “*Fantazimi*” nënkupton:

- A) Mungesën e kënaqësive të porealizuara duke menduar për arritje dhe kënaqësi të fantazuar
- B) Mungesën e kënaqësive të realizuara duke menduar për arritje dhe kënaqësi të fantazuar
- C) Plotësimi i kënaqësive të porealizuara duke menduar për arritje dhe kënaqësi të fantazuar
- D) Plotësimi i kënaqësive të realizuara duke menduar për arritje dhe kënaqësi të fantazuar

Pyetja 20.

Depresioni është episodik kur shenjat e tij shfaqen :

- A) Më pak se 2-vjet
- B) Më pak se 3-vjet
- C) Më pak se 4 vjet
- D) Më pak se 5- vjet

Pyetja 21.

Konsumimi i organizmit sipas psikologes Ajala Pajne përfshin brenda vetes:

- A) Elementë të rraskapitjes materiale
- B) Elementë të rraskapitjes mendore
- C) Elementë të rraskapitjes profesionale
- D) Elementë të rraskapitjes shpirtërore

Pyetja 22.

Shkalla e ripërshtatjes sociale që ka si synim të masën nivelin e stresit që shkaktohet nga ndryshimet jetësore u përpunua nga studiuesit:

- A) Farlin dhe Tobias
- B) Holmes dhe Rahe
- C) Minden dhe Seley
- D) Kyriocou dhe Farlin

Pyetja 23.

Përballja me një alternativë të vetme që përmban në të njëjtën kohë si aspekte positive dhe aspekte negative është karakteristikë e tipit të konfliktit:

- A) Të shumëfishtë Tërheqje-Shmangie
- B) Tërheqje-Shmangie
- C) Tërheqje-Tërheqje
- D) Shmangie-Tërheqje

Pyetja 24.

Përballja dhe të menduarit me çdo rrethanë që pengon ose bllokon plotësimin e synimeve tona na bën të ndjehemi të:

- A) Frustruar
- B) Frikësuar
- C) Presionuar
- D) Vetmitar

Pyetje 25.

Përballja me kërkesa të forta dhe këmbëngulëse për të vepruar në një mënyrë të caktuar na bën të përjetojmë:

- A) Frikë
- B) Frustracion
- C) Panik
- D) Presion

Pyetja 26.

Ne arrijmë të formojmë një mendim pozitiv për veten nëse:

- A) Formojmë standartet tona për të vlerësuar veten tonë
- B) Formojmë standartet tona për të na vlerësuar të tjerët
- C) Formojmë standartet tona nisur nga mendimi pozitiv i të tjerëve
- D) Formojmë standartet tona nisur nga mendimi negativ i të tjerëve

Pyetja 27.

Në gjëndje stresi shpesh i ndihmojmë të tjerët për të vlerësuar dhe gjykuar më mirë problemet që i stresojnë. Në këtë rast mbështetja që ofrohet është:

- A) Mbështetje emocionale
- B) Mbështetje informative
- C) Mbështetje materiale
- D) Mbështetje vlerësuese

Pyetja 28.

Mënyra më e mirë për të vlerësuar veten përgjatë një situatë të dhënë është:

- A) Të vlerësosh dhe të pranosh veten nisur nga kushtet e vendosura te vetja
- B) Të vlerësosh dhe të pranosh veten duke e krahasuar me individë të tjerë
- C) Të vlerësosh dhe të pranosh veten nga informacionet që kemi mbi veten
- D) Të vlerësosh dhe të pranosh veten mbi mendimet që të tjerët kanë për ne

Pyetja 29.

Sipas psikologes Marvin Zukerman personat që ndihen rehat në nivele të larta të nxitjes fiziologjike që për të tjerët perceptohet si stresante i përkasin:

- A) Tipit A të personalitetit
- B) Tipit B të personalitetit
- C) Tipit O të personalitetit
- D) Tipit T të personalitetit

Pyetja 30.

Synimi i teknikave shmangëse të stresit është:

- A) Të na përqëndrojë vëmëndjen tonë te problemi stresor
- B) Të na ndërgjegjësojë për problemin që ne na streson
- C) Të na rrisë përqëndrimin tonë te problem që na streson
- D) Të na shmangë vëmëndjen tonë nga problemi që na streson

Pyetja 31.

Ne arrijmë gjendje të thellë relaksimi kur :

- A) jemi në gjumë
- B) jemi duke lexuar
- C) jemi duke pushuar
- D) jemi të qetë

Pyetja 32.

Meditimi është një teknikë relaksuese e cila e ka origjinën në:

- A) Finlandë
- B) Indi
- C) Japoni
- D) Kinë

Pyetja 33.

Praktikimi i Meditimit si teknikë relaksuese e jep efektin e saj të sigurt:

- A) 1 -2 javë nga koha e fillimit të praktikimit
- B) 2-3 javë nga koha e fillimit të praktikimit
- C) 3-6 javë nga koha e fillimit të praktikimit
- D) 4-1 javë nga koha e fillimit të praktikimit

Pyetja 34.

Më shpesh i rrezikur nga hemoragjia cerebrale dhe sëmundje të zemrës gjatë situatave stresante është :

- A) Tipi A i sjelljes
- B) Tipi B i sjelljes
- C) Tipi O i sjelljes
- D) Tipi T i sjelljes

Pyetja 35.

Teknika e relaksimit progresiv u përpunua nga;

- A) Edmund Jakobson
- B) Hans Seley
- C) Harold Minden
- D) Joseph Wolpe

Pyetja 36.

Cila nga teknikat e mëposhtme relaksuese ndihmon në luftimin e alkolizmit dhe përdorimit të drogës?

- A) Relaksimi autogjenik
- B) Relaksimi me imazheve
- C) Relaksimi me figura
- D) Relaksimi progresiv

Pyetja 37.

Gjendja e frymëmarrjes kur ne marim frymë me anë të gjoksit në mënyrë shumë të shpejt 12-16 herë në minutë quhet ndryshe:

- A) Hiperventilim
- B) Hipoventilim
- C) Hyperventilim
- D) Hypoventilim

Pyetja 38.

Ne marrim frymë me anë të diafragmës nëse:

- A) Nëse në fillim të çdo frymëmarrje ngrihet më parë barku
- B) Nëse në fillim të çdo frymëmarrje ngrihet më parë gjoksi
- C) Nëse në fillim të çdo frymëmarrje ulet më parë barku
- D) Nëse në fillim të çdo frymëmarrje ulet më parë gjoksi

Pyetje 39.

Relaksimi ka efekte fiziologjike plotësisht të kundërta me :

- A) Ankthin
- B) Depresionin
- C) Frikën
- D) Panikun

Pyetja 40.

Teknika relaksuese e cila redukton ankthin shkallë-shkallë tek individi quhet:

- A) Desensibilizimi sistematik
- B) Frymëmarrja diafragmatik
- C) Relaksimi autogjenik
- D) Relaksim progresiv

Pyetja 41.

Cila nga teknikat e mëposhtme relaksuese lufton ankthin e të folurit në vende publike?

- Desensibilizimi sistematik
- Meditimi
- Relaksimi autogjenik
- Relaksimi përmes imazheve

Pyetja 42.

Cila nga teknikat e mëposhtme relaksuese përdor forcën e mendjes për të relaksuar individin kur është i stresuar?

- Relaksimi autogjenik
- Relaksimi progresiv
- Relaksimi përmes imazheve
- Relaksimi me imazhe

Pyetja 43.

Teknika e relaksimit autogjenik u përpunua në vitin 1932 nga neurologu gjerman:

- A) Harold Minden

- B) Hans Seley
- C) Johann Schultz
- D) Joseph Wolpe

Pyetja 44.

Themeluesi i terapisë racionale – emotive që synon reduktimin e stresit është :

- A) Albert Ellis
- B) Hans Seley
- C) Johann Schultz
- D) Joseph Wolpe

Pyetja 45.

Të menduarit në mënyrë të shtrembëruar ka lidhje të drejtpërdrejt me besimin :

- A) Iracional
- B) Të fortë
- C) Të plotë
- D) Racional

Pyetja 46.

Ose i bardhë ose i zi, i përket shprehjes së shtrembërimit kognitiv:

- A) Të menduarit të polarizuar
- B) Të menduarit të përgjithësuar
- C) Të menduarit të stërvogëlizuar
- D) Të menduarit të personalizuar

Pyetja 47:

“Unë duhet pajtetër ta lexoj këtë libër”, i përket shprehjes së shtrembërimit kognitiv:

- A) Të menduarit absolutik
- B) Të menduarit arsyetues
- C) Të menduarit të polarizuar
- D) Të menduarit me zë

Pyetja 48:

Cila nga teknikat e mëposhtme na ndihmon të zëvendësojmë besimet tona iracionale me ato racionale?

- A) Teknika ABC
- B) Teknika ABCDE
- C) Teknika MP
- D) Teknika PSHSP

Pyetja 49.

“Ne mendojmë se dimë përfundimin e ndodhive duke përfshirë dhe të papriturat” ,në këtë rast kemi të bëjmë me shtrembërimin kognitiv:

- A) Arsyetim emocional
- B) Lexues i mendjes
- C) Mendim i polarizuar
- D) Parashikues fati

Pyetja 50.

Teknika që na ndihmon për të zëvendësuar të folurin e brëndshëm negativ me një monolog pozitiv është:

- A) Teknika e të folurit të brëndshëm negativ
- B) Teknika e të folurit të brëndshëm pozitiv
- C) Teknika e të folurit të jashtëm negativ
- D) Teknika e të folurit të jashtëm pozitiv

Pyetja 51.

Ndërprerja e rrjedhës së mendimeve stresantë është qëllimi i teknikës:

- A) Implozioniste
- B) Ndryshimit të mjedisit
- C) Të shtyrit e mendimit stresant
- D) Stopimit të mendimeve

Pyetja 52.

Më shumë stres përjetojnë personat që i përkasin tipit të sjelljes:

- A) A
- B) B
- C) T
- D) O

Pyetja 53.

Cila nga sjelljet e mëposhtme shkakton stres të vetshaktuar?

- A) Sjella asertive
- B) Sjellja agresive
- C) Sjellja jo asertive
- D) Sjellja jo agresive

Pyetja 54.

Ne përjetojmë më shumë stres kur sillemi në mënyrë:

- A) Asertive
- B) Jo asertive
- C) Agresive
- D) Jo agresive

Pyetja 55.

Një nga teknikat e mëposhtme që na ndihmon të trajtojmë një marrëdhënie konfliktuale mes nesh dhe dikujt tjetër në mënyrë asertive është :

- A) Teknika ABC
- B) Teknika ABCDE
- C) Teknika PSHS
- D) Teknika PSHSP

Pyetja 56.

Teknika Magnetofoni i prishur ka si qëllim:

- A) Të qartësojë mirë atë që dëshirojmë kur jemi të tensionuar
- B) Të qartësojë mirë atë që dëshirojmë duke u tensionuar
- C) Të qartësojë mirë atë që dëshirojmë pa u tensionuar
- D) Të qartësojë mirë atë që dëshirojmë ndërsa jemi të tensionuar

Pyetja 57.

Tipi A i sjelljes nga pikëpamja fiziologjike do të thotë:

- A) Reagim i alarmit
- B) Reagim i konsumit
- C) Reagim i rezistencës
- D) Reagim i rraskapitjes

Pyetja 58.

Cila nga teknikat e mëposhtme na ndihmon të administrojmë kohën?

- A) Teknika Çarmatosja e zemërimit
- A) Teknika Hajduti më i madh i kohës
- B) Teknika Magnetofoni i prishur
- C) Teknika e Tre sirtarëve dhe koshit të letrave

Pyetja 59.

Klasifikimi i aktiviteteve tona mbi bazën e prioritetit që ato tek ne është pjesë e punës së teknikës:

- A) Hajduti më i madh i kohës
- B) Magnetofoni i prishur
- C) Stopimi i mendimeve
- D) Tre sirtarët dhe koshi i letrave

Pyetja 60.

Praktikimi i aktiviteteve fizike aerobike që përfshijnë lëvizje të përsëritura ritmike bëjnë që pulsi i zemrës tonë të ngrihet dhe të mbetet në zonën optimal në kufijtë e minutazhit:

- A) 10-20 min
- B) 20-30 min
- C) 30-40 min
- D) 40-50 min

Pyetja 61.

Ne perceptojmë dhe vlerësojmë diçka si stresante me anë të :

- E) Gjëndrës Pituitare
- F) Hipotalamusit
- G) Korteksit Adrenal
- H) Korteksit Cerebral

Pyetja 62.

Realizimi i emocioneve tek njeriu arrihet nëpërmjet strukturës trunore që njihet me emrin:

- E) Gjendra Pituitare
- F) Gjendra Tiroide
- G) Hipotalamusi
- H) Korteksi Cerebral

Pyetja 63.

Funksioni i seksionit simpatik i sistemit nervor në organizëm është:

- A) Të pakësojë energjinë trupore
- B) Të përdorë energjinë trupore
- C) Të ruajë energjinë trupore
- D) Të shtojë energjinë trupore

Pyetja 64.

Mobilizimin e rezervave të trupit për të përballuar situatën stresante Valter Kanon e quajti:

- A) Reagim lufte ose afrimi
- B) Reagim lufte ose fitore
- C) Reagim lufte ose ikje
- D) Reagim lufte ose presioni

Pyetja 65.

Hipotalamusi gjatë një situatë stresante i përcjell mesazhet urgjente drejt:

- A) Gjëndrës Pituitare
- B) Gjëndrës Tiroide
- C) Korteksit Adrenal
- D) Korteksit Cerebral

Pyetja 66.

Sipas Hans Selye reagimi i trupit ndaj një stresori kalon në:

- A) 2 Faza
- B) 3 faza
- C) 4 faza
- D) 5 faza

Pyetja 67.

Sëmundjet më të shumta që lidhen me stresin sipas Hans Selyes zhvillohen gjatë fazës së :

- A) Alarmit
- B) Mobilizimit
- C) Rezistencës
- D) Rraskapitjes

Pyetja 68.

Me homeostazë të organizmit kuptohet:

- A) Niveli normal i funksionimit vetëm të një organi në trupin tonë
- B) Disniveli normal i funksionimit vetëm të një organi në trupin tonë
- C) Niveli normal i funksionimit të çdo organi në trupin tonë
- D) Disniveli normal i funksionimit të çdo organi në trupin tonë

Pyetja 69.

Hipertensioni që shkaktohet nga trashëgimia , mbipesha, stresi njihet si:

- A) Hipertension primar
- B) Hipertension sekondar
- C) Hipotension primar
- D) Hipotension sekondar

Pyetja 70.

Mekanizmi fiziologjik me të cilin stresi favorizon zhvillimin e kancerit është:

- A) Sekretimi i tepërt i hormonit të kortisolit çon në pakësim të limfociteve
- B) Sekretimi i pakët i hormonit të kortisolit çon në pakësim të limfociteve
- C) Sekretimi i tepërt i hormonit të kortisolit çon në shtim të limfociteve
- D) Sekretimi i tepërt i hormonit të kortisolit çon në shtim të limfociteve

Pyetja 71.

Ankthi i papritur i shoqëruar me tension fizik dhe mendimin se diçka e keqe do ndodhë njihet si:

- A) Ankthi i përgjithësuar
- B) Fobi
- C) Panik
- D) Obsesion

Pyetja 72.

Përrjetimi i ankthit të përgjithësuar tek njeriu zgjat me :

- A) Ditë
- B) Javë
- C) Muaj
- D) Orë

Pyetja 73.

Frika e vazhdueshme për dukuri të ndryshme që është jashtë proporcionit të rrezikut real që paraqesin këto dukuri quhet:

- A) Fobi

- B) Panik
- C) Obsesion
- D) Kompulsion

Pyetja 74.

Mekanizmi mbrojtës ku cilësitë tona të padëshirueshme që nuk duam ti'a njohim vetes dhe ua veshim të tjerëve quhet:

- A) Projeksion
- B) Regresion
- C) Represion
- D) Zhvendosje

Pyetja 75.

Mekanizmi mbrojtës që ne përdorim për të justifikuar veprimet tona duke dhënë arsye të paqëna në vend të arsyeve të vërteta është :

- A) Racionalizmi
- B) Reagimi kundërt
- C) Regresioni
- D) Represioni

Pyetja 76.

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një shqetësim i zakonshëm i jetës së përditshme?

- A) Divorci
- B) Gatimi
- C) Vapa
- D) Veshja

Pyetja 77.

Gjendja në të cilën ne nuk jemi të aftë të plotësojmë nevojat tona për disa lloje të marrëdhënieve sociale quhet:

- A) Frikë
- B) Frustracion
- C) Panik
- D) Vetmi

Pyetja 78.

Sinjali i ndodhjes dhe kohëzgjatjes së diçkaje të padëshiruar është quajtur:

- A) Sinjali alarmit

- B) Sinjali i mobilizimit
- C) Sinjali i rrezikut
- D) Sinjali i shpëtimit

Pyetja 79.

Sipas psikologes Suzana Kobasa ne i përkasim personalitetit të Tipit të Fortë nëse jemi:

- A) Të fortë emocionalisht
- B) Të fortë fizikisht
- C) Të fortë fiziologjikisht
- D) Të fortë psikologjikisht

Pyetja 80.

Teknika relaksuese e cila ndihmon në reduktimin e dhimbjes që shkaktohet nga ulçera është:

- A) Relaksimi autogjenik
- B) Relaksimi progresiv
- C) Relaksimi përmes imazheve
- D) Frymëmarrja diaframatike

PSIKOLOGJI SHKOLLORE

Pyetja 1.

Fundi i shekullit IX dhe fillimi i shekullit XX përkojnë me zhvillimin e një fushe të re të psikologjisë që njihet me emrin:

- A) Psikologji Aplikative
- B) Psikologji Edukimi
- C) Psikologji Shkollore
- D) Psikologji Zhvillimi

Pyetja 2.

Laboratori i parë psikofizik u hap në vitin 1900 nga :

- A) Smedly
- B) Hall
- C) Macmillan
- D) Nunson

Pyetja 3.

Byroja e Studimit të Fëmijëve u hap për herë të parë nga Macmilan në vitin:

- A) 1900

- B) 1901
- C) 1902
- D) 1903

Pyetja 4.

Psikologu i parë shkollor në botë është:

- A) Kornell
- B) Macmillan
- C) Nunson
- D) Symon

Pyetja 5.

Shërbimi psikologjik u fut për herë të parë në shkollat e:

- A) Amerikës
- B) Belgjikës
- C) Çikagos
- D) Hollandës

Pyetja 6.

Klinika e parë psikologjike për fëmijët që kishin probleme në shkollë u hap për herë të parë nga:

- A) Fredly
- B) Macmillan
- C) Symon
- D) Witmer

Pyetje 7.

Faza e dytë e zhvillimit të psikologjisë shkollore karakterizohet nga:

- A) Hapja e klinikës psikologjike për fëmijët me probleme në shkollë
- B) Përcaktimin e detyrave të psikologut shkollor bazuar në profesion
- C) Përpjekja për të legalizuar institucionet e psikologjisë shkollore
- D) Rritja në përmasa të mëdha e profesionit të psikologut në shkolla

Pyetja 8.

Ndarja e psikologut shkollor nga ai klinikist u bë:

- A) Pas viteve 20 të shek.XX
- B) Pas viteve 30 të shek.XX
- C) Pas viteve 40 të shek.XX
- D) Pas viteve 70 të shek.XX

Pyetja 9.

Konsultimi ku fokusohet puna e psikologut shkollor ka si karakteristikë kryesore:

- A) Nxitjen e konfliktit në marrëdhënien e punës ndërmjet prindërve, edukatorëve dhe shërbimeve të komunitetit
- B) Nxitjen e nivelit të rritjes së marrëdhënieve të punës ndërmjet prindërve, edukatorëve dhe shërbimeve të komunitetit
- C) Nxitjen e pakënaqësisë në marrëdhënien e punës ndërmjet prindërve, edukatorëve dhe shërbimeve të komunitetit
- D) Nxitjen e zvogëlimit të marrëdhënieve të punës ndërmjet prindërve, edukatorëve dhe shërbimeve të komunitetit

Pyetja 10.

Komunikimi midis dy njerëzve me anë të lidhjes diadike nënkupton :

- A) Komunikimin me anë të procesin të folurit
- B) Komunikimin pa përdorur procesin e folurit
- C) Komunikimin duke përdorur të folurin verbal
- D) Komunikimin duke përdorur sinjale dhe fjalë

Pyetja 11.

Sinkrona komunikuese gjatë procesit të komunikimit midis dy njerëzve na ndihmon të kuptojmë:

- A) Kur bashkëbiseduesi nuk është duke kuptuar
- B) Kur bashkëbiseduesi nuk është i qartësuar
- C) Kur bashkëbiseduesi nuk është duke folur
- D) Kur bashkëbiseduesi nuk është i vëmëndshëm

Pyetja 12.

Funksionimi i faktorit politesë midis grupeve sociale në institucionin shkollor konsiston në:

- A) Komunikimin midis grupeve sociale jo në bazë statusi
- B) Komunikimin midis grupeve sociale në bazë të statusit
- C) Komunikimin me paragjykime statusi midis grupeve
- D) Komunikimin pa paragjykime statusi midis grupeve

Pyetja 13.

Përshtatja e nxënësve me rregullat e shkollës shihet si:

- A) Konformizëm
- B) Konstruktionizëm
- C) Konstruktivizëm
- D) Kompromentues

Pyetja 14.

Ora e mësimit në procesin e mësimdhënies shihet si:

- A) Aktivitet ku mësuesi dhe nxënësi vihen përballë
- B) Aktivitet ku mësuesi shpjegon dhe nxënësi dëgjon
- C) Aktivitet ku nxënësi testohet për njohuritë që ka
- D) Aktivitet ku nxënësi merr vetëm njohuri nga mësuesi

Pyetja 15.

Mësuesi duhet të njohë nga ana psikologjike elementët e mësimit pasi kjo ndihmon në:

- A) Krijimin e kushteve për ndërhyrjen e psikologut shkollor mbi sjelljet normale që kanë nxënësit
- B) Krijimin e kushteve për ndërhyrjen e psikologut shkollor gjatë diskutimeve mësues-nxënës
- C) Krijimin e kushteve për ndërhyrjen e psikologut shkollor mbi sjelljet problematike të nxënësve
- D) Krijimin e kushteve për ndërhyrjen e psikologut shkollor gjatë këshillimit midis mësuesit e nxënësit

Pyetja 16.

Roli i mësuesit si udhëheqës në institucionin shkollor nënkupton :

- A) Udhëheqës i i aktiviteteve që ka shkolla
- B) Udhëheqës i diskutimeve që ka shkolla
- C) Udhëheqës i orës së mësimit në shkollë
- D) Udhëheqës i vendimeve që ka shkolla

Pyetja 17.

Trajtimi i njëjtë i grupeve gjinore në klasë është karakteristikë e:

- A) Mësuesit miqësor
- B) Mësuesit moderator
- C) Mësuesit qytetar
- D) Mësuesit udhëheqës

Pyetja 18.

Konsultimi psikologjik indirekt në shkollë ndërmeret nga:

- A) Mësuesi
- B) Nxënësi
- C) Prindi
- D) Psikologu

Pyetja 19.

Konsultimi psikologjik direkt në shkollë ndërmeret nga :

- A) Drejtuesi
- B) Mësuesi
- C) Prindi
- D) Psikologu

Pyetja 20.

“Në fillim identifikohet problemi nga psikologu shkollor” është hapi i parë i ndërhrytjes së modelit:

- A) Bergan
- B) Goodwin
- C) Glosser
- D) Gutkin

Pyetja 21.

Elementi kompromentues në institucionin shkollor shfaqet tek:

- A) Pozicioni që ka mësuesi
- B) Pozicioni që ka nxënësi
- C) Pozicioni që ka prindi
- D) Pozicioni që ka psikologu

Pyetja 22.

Një nga aftësitë që këshilluesi shkollor nuk duhet të paraqesë në procesin e këshillimit është:

- A) Autoriteti
- B) Besimi
- C) Konfidenca
- D) Simpatia

Pyetja 23.

Elementi më i spikatur për vendosjen e një marrëdhënie të suksesshme midis këshilluesit dhe nxënësit gjatë procesit të konsultimit është:

- A) Dëgjimi i kujdesshëm i këshilluesit
- B) Kuptimi i pauzave nga këshilluesi
- C) Pyetje mbi problemin nga këshilluesi
- D) Vetpërmbytja emocionale e këshilluesit

Pyetja 24.

Rishikimi i problemit është një element i domosdoshëm që e lejon psikologun shkollor:

- A) Të modelojë qëndrimet e tij në përcaktimin e prolemtikave që ndikojnë në sjelljen e nxënësit në shkollë
- B) Të modelojë qëndrimet e tij në përcaktimin e sjelljeve problematike që ndikojnë në sjelljen e nxënësit në shkollë
- C) Të rimodelojë qëndrimet e tij në përcaktimin e sjelljeve të përshtatshme që ndikojnë në sjelljen e nxënësit në shkollë
- D) Të rimodelojë qëndrimet e tij në përcaktimin e problematikave që ndikojnë në sjelljen e nxënësit në shkollë

Pyetja 25.

Synimi i përdorimit të stilit direktiv në procesin e këshillimit është :

- A) Nxënësi të analizojë vetë problemin pa ndihmën e këshilluesit
- B) Nxënësi ti japë vetë zgjidhje problemematikave të ndryshme
- C) Nxënësi të kuptojë situatën për gjetur zgjidhjen e problemit
- D) Nxënësit ti tregohet se çfarë duhet të bëjë për të zgjidhur problemin

Pyetja 26.

Kategorizimi i llojit të dëgjimit në dy drejtimi i mirë dhe i keq u bë nga:

- A) Molnar dhe Lindquist
- B) Nelson dhe Leven
- C) Nelson dhe James
- D) James dhe Bergan

Pyetja 27.

Një ndër momentet kur këshilluesi shkollor duhet të ndërhyjë gjatë procesit të këshillimit është kur:

- A) Këshilluesi nuk është i dëshirueshëm për nxënësin
- B) Këshilluesi kupton që është i dëshirueshëm nga nxënësi
- C) Nxënësi është vetë zgjidhës i situatave problematike
- D) Nxënësi nuk kërkon ndihmë për zgjidhjen e situatës

Pyetja 28.

Modeli që tregon se sjellja e nxënësit ndahet në disa zona sociale është dhënë nga:

- A) Gutkin
- B) Hall
- C) Levin

D) Nelson

Pyetja 29.

Cili nga modelet e mëposhtme me natyrë psikologjike e sheh institucionin shkollor si vëndin më të rëndësishëm për vëzhgimin e nxënësit në periudhën e fëmijërisë?

- A) BERGAN
- B) GINZBERG
- C) MAUD
- D) PYETËSORI I KËRKIMIT TË VETDETYRUAR

Pyetja 30.

Shkalla e interesave sipas modelit Super përkton me moshën e:

- A) Fëmijërisë së hershme
- B) Fëmijërisë së mesme
- C) Fëmijërisë së vonë
- D) Rritur të hershme

Pyetja 31.

Modeli Ginzberg në bazë të moshës së nxënësit përcakton aftësinë profesionale duke i ilustruar në bazë të disa shkallëve. Shkalla e parë e këtij modeli është :

- A) Shkalla Fantazisë
- B) Shkalla Interesave
- C) Shkalla Kapacitetit
- D) Shkalla Tentuese

Pyetja 32.

Modeli Holland që ka si synim të orientojë nxënësit në lidhje me punën e tyre në të ardhmen ndryshe njihet me emrin:

- A) Modeli SUPER
- B) Modeli MAUD
- C) Modeli TERAPISË SË REALITETIT
- D) Modeli PYETËSORIT TË KËRKIMIT TË VËTDETYRUAR

Pyetja 33.

Njësia Psikologjike e Aplikuar (APU) synon të ndihmojë nxënësit që nuk kanë përvojë në zgjedhje të saktë të karrierës duke tentuar të hetojë interesat:

- A) Kolektiv

- B) Ambiental
- C) Okupacional
- D) Material

Pyetja 34.

Sistemi psikologjik që ndihmon nxënësit në përcaktimin e interesave të tyre profesional duke përdorur kompjuterin njihet me emrin:

- A) MAUD
- B) APU
- C) SUPER
- D) PKV

Pyetja 35.

Modeli i kushtëzimit operant që njihet si teknikë e modifikimit të sjelljes bazohet në:

- A) Ripërsëritjen një herë të sjelljes pozitive nga nxënësi dhe eliminimin e sjelljes së gabuar
- B) Ripërsëritjen një herë të sjelljes së gabuar nga nxënësi dhe eliminimin e sjelljes pozitive
- C) Ripërsëritjen disa herë të sjelljes pozitive nga nxënësi dhe eliminimin e sjelljes së gabuara
- D) Ripërsëritjen disa herë të sjelljes së gabuar nga nxënësi dhe eliminimin e sjelljes pozitive

Pyetja 36.

Modeli Glosser është teknikë e modifikimit të sjelljes ku mësuesi duhet të ketë në qendër të punës së tij :

- A) Identifikimin e sjelljes së papërshtatshme në klasë dhe fokusimi në përgjegjësinë që ka nxënësi për mësimin
- B) Identifikimin e sjelljes së përshtatshme në klasë dhe fokusimi në përgjegjësitë që ka nxënësi për mësimin
- C) Identifikimin e përgjegjësisë që ka nxënësi për mësimin dhe fokusimi në sjelljen e papërshtatshme
- D) Identifikimin e përgjegjësisë që ka nxënësi për mësimin dhe fokusimi në sjelljen e përshtatshme

Pyetja 37.

Një nga shkallët e mëposhtme nuk bën pjesë në propozimet e dhëna nga Molnar dhe Lindquist:

- A) Sjellja e nxënësit përcaktohet nga mënyra se si ato individualisht e shprehin këtë sjellje në çdo situatë në klasë

- B) Mësuesi përdor sinjale jo verbale që nxënësi të ndalojë sjelljen e tij të papërshtatshme
- C) Vazhdimisht ka më shumë se një rrugë për të interpretuar sjelljen e një nxënësi
- D) Nëse ndryshon interpretimi i sjelljes atëherë dhe vetë sjellja ndryshon

Pyetja 38.

Mësuesi ndërhyr tek nxënësit që shfaqin sjellje të patolerueshme me teknikën e modifikimit të sjelljes që quhet:

- A) Teknika e pushimit nga forcimi negativ
- B) Teknika e pushimit nga forcimi pozitiv
- C) Teknika e pushimit nga rirforcimi negativ
- D) Teknika e pushimit nga rirforcimi pozitiv

Pyetja 39.

Sanksionet ndëshkuese që përdoren në institucionin shkollor ndahet në dy kategori:

- A) Ndëshkuese positive dhe Ndëshkuese negative
- B) Ndëshkuese positive dhe Përforcuese negative
- C) Ndëshkuese efektive dhe Ndëshkuese jo efektive
- D) Përforcuese efektive dhe Përforcuese jo efektive

Pyetja 40.

Momenti i parë i investigimit të mësuesit ose këshilluesit në sjelljen refuzuese të nxënësit që shfaq ndaj shkollës është:

- A) Analiza e pasojës së largimit të nxënësit dhe vrojtimi
- B) Analiza e shkakut të largimit të nxënësit dhe vrojtimi
- C) Vrojtimi dhe analiza e pasojës së largimit të nxënësit
- D) Vrojtimi dhe analiza e shkakut të largimit të nxënësit

Pyetja 41.

Klinika e parë psikologjike për fëmijët që shfaqnin probleme në shkollë u hap në vitin :

- A) 1890
- B) 1891
- C) 1892
- D) 1893

Pyetja 42.

Insitucioni i Byrosë së Studimit të fëmijës kishte në fokus të punës matjen e karakteristikave të fëmijës-nxënës në aspektin:

- A) Emocional
- B) Fizik
- C) Fiziologjik
- D) Psikologjik

Pyetja 43.

Puna e Byrosë Studimore të Fëmijëve pas vitit 1935 u zëvendësua nga :

- A) Symon
- B) Kornell
- C) Macmilan
- D) Nunson

Pyetja 44.

Për herë të parë ekipet psikosociale që synonin ndërhyrje nga ana sociale dhe psikologjike tek fëmijët e braktisur u ndërtuan në vitin 1919 nga :

- A) Nunson
- B) Healey
- C) Hull
- D) Walter

Pyetja 45.

Faza e tretë e zhvillimit të psikologjisë shkollore përfshiu periudhën e viteve:

- A) 20 të shek. 20
- B) 30 të shek. 20
- C) 40 të shek. 20
- D) 50 të shek. 20

Pyetja 46.

Një përcaktim të saktë dhe konçiz të funksioneve të psikologut shkollor u pa për herë të parë në platformën e dhëna nga:

- A) Nunson
- B) Hull
- C) Walter
- D) Witmer

Pyetja 47.

Struktura e Kornellit mbi punën e psikologut në shkollë bazohej në :

- A) 3 drejtime
- B) 4 drejtime
- C) 5 drejtime
- D) 6 drejtime

Pyetja 48.

“Shoqata e Psikologëve Shkollor” u formua për herë të parë :

- A) Në fillim të viteve 70 të shek. 20
- B) Në fillim të viteve 80 të shek. 20
- C) Në fund të viteve 70 të shek. 20
- D) Në fund të viteve 80 të shek. 20

Pyetja 49.

Akreditimi i programit universitar për përgatitjen e psikologut shkollor për herë të parë u bë në vitin:

- A) 1972
- B) 1973
- C) 1974
- D) 1975

Pyetja 50.

Drejtimi i Shkencave Psikologjike që tenton të trajtojë njohuritë psikologjike të fëmijës - nxënës njihet me emrin:

- A) Psikologji Klinike
- B) Psikologji Sociale
- C) Psikologji Shkollore
- D) Psikologji Zhvillimi

Pyetja 51.

“Gjeneron njohuri të reja rreth të mësuarit dhe sjelljes” është pjesë e drejtimit të punës së psikologut shkollor në shkollë si:

- A) Konsultues
- B) Kërkues e planifikues
- C) Ndërhyrës dhe Intervenues
- D) Furnizues

Pyetja 52.

Statusi më i lartë në institucionin shkollor për nxënësit është ai i :

- A) Drejtuesit
- B) Kujdestarit
- C) Mësuesit
- D) Psikologut

Pyetja 53.

Ridimensioni i sjelljes nën veprimin e faktorit politesë konsiston në vendosjen e :

- A) Komunikimit me bazë paragjyquese statusi midis grupeve
- B) Komunikimit me bazë paragjyquese midis grupeve
- C) Komunikimit pa pasur paragjykime statusi midis grupeve
- D) Komunikimit pa pasur paragjykime midis grupeve

Pyetja 54.

Diferencat në sjellje të nxënësve midis asaj që kishin mësuar jashtë ambientit të shkollës dhe asaj që kërkon mund të eliminohen nëse nxënësit pranojnë një shkallë:

- A) Konformizmi
- B) Konstruktionizmi
- C) Konstruktivizmi
- D) Kompromentimi

Pyetja 55.

Vendosja e marëdhënieve pozitive midis mësuesit dhe nxënësit në klasë vjen fill pas :

- A) Largimit të mësuesit nga mësimi
- B) Përshëndetjes së mësuesit me nxënësit
- C) Përfundimit të marëdhënies mësues-nxënës
- D) Zgjidhjes së detyrave gjatë orës së mësimi

Pyetja 56.

Dhënia e informacionit nga mësuesi është element që ndikon në procesin e:

- A) Komunikimit
- B) Mikpritjet
- C) Miqësisë
- D) Efektivitetit

Pyetja 57.

Investigimi parësor i psikologut shkollor tek nxënësit që shfaqin problematika në shkollë duhet të bazohet tek:

- A) Aftësitë komunikuese të mësuesit gjatë orës së mësimit
- B) Aftësitë menaxhuese të mësuesit gjatë orës së mësimit
- C) Aftësitë sociale të mësuesit gjatë orës së mësimit
- D) Aftësitë udhëheqëse të mësuesit gjatë orës së mësimit

Pyetja 58.

Një mësues që mbështet klasën me elementët pozitiv e negativ të saj karakterizohet si cilësi:

- A) Komunikuese
- B) Motivuese
- C) Mikpritëse
- D) Udhëheqëse

Pyetja 59.

Ndërhyrja për të eliminuar sjelljen shantaziste të nxënësit në klasë realizohet nga disa hapa ku “Regjistrimi i sjelljes shantaziste nga ana e mësuesit” është :

- A) Hapi i I
- B) Hapi II
- C) Hapi III
- D) Hapi IV

Pyetja 60.

Në dy rrymat e konsultimit shkollor grupet përbërëse që marin pjesë në konsultim janë :

- A) Drejtues, mësues, nxënës
- B) Mësues, nxënës, nxënës
- C) Mësues, psikolog, nxënës
- D) Psikolog, prind, nxënës

Pyetja 61.

Modeli i konsultimit shkollor Goodwin përbëhet nga :

- A) III hapa
- B) VI hapa
- C) IX hapa
- D) XII hapa

Pyetja 62.

Dy elementët bazë që ndikojnë në procesin e këshillimit të mësuesit ndaj nxënësit janë:

- A) Empatia dhe Simpatia
- B) Konfidenca dhe Miqësia

- C) Konfidenca dhe Simpatia
- D) Simpatia dhe Miqësia

Pyetja 63.

Për të zgjidhur kontraditën që shfaq shpesh herë pozicioni i mësuesit me nxënësit në shkollë duhet të jetë i pranishëm:

- A) Shërbimi Ligjor
- B) Shërbimi Mjekësor
- C) Shërbimi Psikologjik
- D) Shërbimi Sanitar

Pyetja 64.

Në procesin e këshillimit duhet të kemi parasysh dy komponentë:

- A) Teorik dhe Analizues
- B) Teorik dhe Ndërhyrës
- C) Teorik dhe Praktik
- D) Teorik dhe Vlerësues

Pyetja 65.

Kur një nxënës në shkollë përballet me interesa që kanë të njëjtën tërheqje nga ana e tij themi që po përjeton tipin e konfliktit:

- A) Afrim-Shmangie
- B) Tërheqje-Tërheqje
- C) Shmangie-Shmangie
- D) Shmangie-Afrim

Pyetja 66

Shkalla e fantazisë sipas modelit të Ginzberg përkon me moshën e :

- A) Fëmijërinë së hershme
- B) Fëmijërinë së mesme
- C) Fëmijërisë së vonë
- D) Rritur të hershme

Pyetja 67.

Sistemi i këshillimit që synon ndarjen e punës nga ana e nxënësit në aspektin ambientalist dhe okupacional është dhënë nga :

- A) Ginzberg
- B) Hull

- C) Holland
- D) Walter

Pyetja 68.

Modeli i terapisë së realitetit i dhënë nga Glosser për të punuar mbi sjelljen e papërshtatshme të nxënësit në klasë përbëhet nga:

- A) 4 faza
- B) 5 faza
- C) 6 faza
- D) 7 faza

Pyetja 69.

Sanksioni “Ligji i konsekuencave natyrale mbi nxënësin” pohon se:

- A) Konsekuenca që bie nga ana e ambientit mbi nxënësin është më e madhe se sa konsekuenca që bie nga ana e mësuesit
- B) Konsekuenca që bie nga ana e ambientit mbi nxënësin është në raport të barabartë me konsekuencën që bie nga ana e mësuesit
- C) Konsekuenca që bie nga ana e ambientit mbi nxënësin është në raport të kundërt me konsekuencën që bie nga ana e mësuesit
- D) Konsekuenca që bie nga ana e ambientit mbi nxënësin është më e vogël se sa konsekuenca që bie nga ana e mësuesit

Pyetja 70.

Cili nga sanksionet e mëposhtme jep më shumë efekt në modifikimin e sjelljes problematike të nxënësit në klasë?

- A) Aplikimi i të folurit verbal të mësuesit ndaj nxënësit mbi sjelljen problematike të tij
- B) Lajmërimi i prindërve nga ana e mësuesit mbi sjelljen problematike që shfaq nxënësi
- C) Organizimi i një takimi me prindër për sjelljet problematike që shfaqen në klasë
- D) Aplikimi i konsekuencave natyrale mbi nxënësin nga mësuesi mbi sjelljen problematike